



Ref. nr.

3007/2


Prishtinë

06/11/2023

Formulari F3

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TE DIPLOMËS
MASTER

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT				
Vendimi i Këshillit të FIN-it	Nr.	1875/1	Date	21/07/2023
Komisioni vlerësues sipas vendimit të këshillit	1.	Prof.asoc.Dr. Figene Ahmedi	Kryetar	
	2.	Prof. Dr. Laura Kusari	Mentor	
	3.	Prof..Asist. Dr. Lavdim Osmanaj	Anëtar	
Emri i projekt propozimit i miratuar sipas vendimit të këshillit të FIN.	MODELIMI HIDRAULIK I VËRSHIMEVE NE LUMIN KLINA			
Vlerësimi i dorëshkrimit				
<p>Per punimin e diplomës master me titull "Modelimi hidraulik i vërshimeve në lumin Klina" i kandidatit Bledar Hajdari, bachelor i Ndërtimtarisë, departamenti Hidroteknikës, komisioni i emeruar nga departamenti i Hidroteknikes dhe i miratuar nga Keshilli i FIN, ne perberje:</p> <ol style="list-style-type: none">1. Prof.asoc.Dr. Figene Ahmedi2. Prof. Dr. Laura Kusari, mentor3. Prof..Asis. Dr. Lavdim Osmanaj <p>Keshillit te Fakultetit te Inxhinierise se Ndertimit, ia paraqet kete Raport.</p> <p>Duke u nisur edhe ngjarjet e koheve te fundit dhe paraqitjen e vazhdueshme tevershimeve, te nje frekuence dhe magnitude ne vazhdimesi ne rritje, angazhimi me i madh i kandidatit ne kete punim diplome ka qene analiza e vërshimeve qe po ndodhin ne komunën e Skënderajit dhe masat eventuale qe duhet te ndërmerren me qëllim të zbutjes së dëmeve nga vërshimet. Kjo temë e masterit ka filluar me studimin e literaturës me qëllim të hulumtimit ne lidhje me masat qe duhet te ndërmerren me qëllim të zbutjes së dëmeve nga vërshimet. Për punimin e këtij hulumtimi studenti ka hulumtuar dhe analizuar literaturën e huaj dhe hulumtimet ne kete fushe. Studenti ka përshkruar në përgjithësi kuptimin mbi lumenjtë, reshjet dhe matjet e tyre. Me pas ka vazhduar me rastin studmior, matjet hidrometrike, informatat mbi komunën e Skënderajit, në të cilën përfshihen pozita gjeografike, karakteristikat morfologjike, klimatike dhe hidrologjike si dhe ne baze te te dhenave te mesiperme ka arritur te pjesa e modelimit hidraulik të lumit Klina.</p>				



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, Ndërtesa e “Fakulteteve Teknike”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 554 899

URL: <https://fin.uni-pr.edu>

e-mail: fin@uni-pr.edu

Ref. nr. _____

Prishtinë ____/____/____

Per kete qellim, së pari janë bërë matjet gjeodezike të pellgut dhe shtratit të lumit dhe është krijuar sipërfaqja gjeodezike prej së cilës është bërë modelimi hidraulik.

Qëllimi i përgjithshëm i punimit është bërja e një analize e cila do të ndihmojë në kuptimin e vërshimeve në komunën e Skënderajit dhe mbrojtjen nga ujërat e mëdha të cilat dita ditës po shkaktojnë dëme të mëdha ekonomike.

Si objektivi i këtij punimi është çasja për ballafaqimin me këto probleme dhe ofrimi i zgjidhjeve praktike.

Si teza kryesore që janë shqyrtuar në këtë punim diplome janë:


- Sa është i rrezikuar qyteti i Skënderajit nga vërshimet,
- Analiza e prurjeve hidrologjike ndër vite dhe niveli i vërshimeve për prurjet hidrologjike të ndryshme,
- Modelimi i përmbajtjeve të lumit Klina për prurje hidrologjike të ndryshme

Punimi i diplomes me titull “Modelimi hidraulik i vërshimeve në lumin Klina” është organizuar në përmbajtje si në vazhdim. Punimi ka gjithsej 113 faqe, 45 figura dhe 8 tabela. Punimi fillon me abstraktin në gjuhën shqipe dhe angleze, dhe vazhdon me hyrjen ku janë përshkruar në detaje pjesët përmbajtëse të punimit. Punimi është ndarë në 5 kapituj.

Kapitulli i parë përmban pjesën hyrëse të temës që trajtohet, qëllimin e hulumtimit dhe metodologjinë e përdorur. Ndikimet e vërshimeve të cilat mund të jenë shkatërrimtare. Ato mund të çojnë në shkatërrimin e ndërtesave, rrugëve, urave, dhe infrastrukturës tjetër. Ujërat e mëdha mund të kontaminojnë burimet e ujit, duke shkaktuar rrezikun e sëmundjeve të përcjellura me ujë.

Kapitulli i dytë përmban hulumtimin e literaturës, ku shtjellohen lumenjtë dhe karakteristikat e tyre kryesore, matjet hidrometrike në lumenje, instrumente matëse, reshjet dhe vërshimet në përgjithësi. Në këtë pjesë janë dhënë edhe shembuj të modeleve hidrologjike fillestrare dhe deri në ato të koheve të fundit. Në këtë pjesë janë dhënë edhe masat e njohura në literaturë për mbrojtjen nga vërshimet.

Kapitulli i tretë përmban modelimin e lumit Klina. Në fillim është dhënë informata mbi gjendjen ekzistuese në lumin Klina, dhe me pas në baze të të dhënave hidrologjike për lumin Klina, janë bërë llogaritjet hidrologjike të prurjeve të lumit me metodat statistikore për përcaktimin e prurjeve maksimale shumëvjeçare, pastaj për ato prurje është bërë modelimi hidraulik i vërshimeve për segmentin e trajtuar dhe në fund janë paraqitur masat mbrojtëse nga këto vërshime. Lumi Klina shtrihet përgjatë qendrës së komunës së Skënderajit dhe vazhdimisht shkakton vërshime kur ka reshje me intensitet të madh apo edhe prej shkrirjes së borës gjatë stinës së pranverës.



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, Ndërtesa e “Fakulteteve Teknike”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 554 899

URL: <https://fin.uni-pr.edu>

e-mail: fin@uni-pr.edu

Ref. nr. _____

Prishtinë ____/____/____

Në kapitullin e katërt janë prezentuar rezultatet e këtij hulumtimi si dhe diskutimet në lidhje me to. Duke u bazuar në prurjet maksimale 20, 50 dhe 100 vjeçare, është bërë modeli hidraulik i lumit Klina ku në bazë të rezultateve, është parë se shtrati i lumit të rregulluar nuk ka mundësi të përballojë prurjet maksimale, andaj qyteti i Skënderajit është i rrezikuar nga këto ujëra të mëdha, saherë që paraqiten. Në bazë të këtij hulumtimi, shohim se shtrati ekzistues i rregulluar nuk ka aftësi të mjaftueshme t'i përballojë prurjet maksimale 20, 50 dhe 100 vjeçare.

Në kapitullin pestë është bërë prezantimi i përfundimeve dhe rekomandimeve. Lumi Klina, shkakton vërshime çdo vit kur paraqiten ujërat e mëdha si pasojë e intensiteti të lartë. Përmes matjeve gjeodezike të pellgut të segmentit të trajtuar të lumit Klina, llogaritjeve hidrologjike dhe modelimit hidraulik kandidati ka arritur në këto përfundime:

- Shtrati ekzistues i rregulluar ka gjerësi të vogël dhe nuk mund të përballojë prurjet maksimale;
- Rrezikimi i vendbanimeve buzë lumit nga përmytjet e viteve të ardhshme është një sfidë e vazhdueshme dhe ka lidhje të ngushtë me ndryshimet klimatike dhe ndërhyrjet njerëzore në rrjedhën e lumit.
- Në të dy anët e shtratit të lumit të rregulluar do të bëhen vërshime të sipërfaqeve. Në anën e djathtë në kahje me ujërrjedhjen e ujit, do të kemi dëme më të mëdha si pasojë e numrit më të madh të objekteve të banimit dhe bizneseve


Me qëllim të zbutjes sa më të madhe të dëmeve nga vërshimet, janë bërë disa rekomandime:

- Të bëhen matje hidrometrike të vazhdueshme shumëvjeçare, në mënyrë që të bëhen analiza më të sakta për mbrojtjen ndaj vërshimeve;
- Të bëhet pastrimi i shtratit të lumit në mënyrë të vazhdueshme dhe të mos hudhen mbeturina;
- Me qëllim të mbrojtjes nga vërshimet duhet të bëhet ndërtimi i argjinaturave sekondare në tërë gjatësinë e segmentit të trajtuar, pasi që shtrati aktual i rregulluar nuk ka aftësi të përballojë prurjet maksimale.
- Të mirëmbahet rrjeti i kanalizimit atmosferik të qytetit të Skënderajit;
- Të rritet vetëdija e qytetarëve që të mos bëhen ndërtime afër shtratit të lumit;
- Të bëhet validimi i modelit të përmytjes dhe të përditësohet modeli i vërshimeve.

Vlerësimi i punimit

Punimi në fjale ka arritur të përmbushë objektivat e punimit dhe të japë përgjigje në hipotezat e parashtruara në fillim. Hulumtimi në literature ka qenë i detajuar dhe i fokusuar në fushën e këtij studimi, për të ofruar zgjedhjen më të mirë të mundshme në fushën e mbrojtjes nga vërshimet përmes modelimit të lumit Klina.

Propozimi i komisionit



UNIVERSITETI I PRISHTINËS

“HASAN PRISHTINA”

UNIVERSITY OF PRISTINA

FAKULTETI I INXHINIERISË SË NDËRTIMIT – CIVIL ENGINEERING FACULTY

Rr. Agim Ramadani, Ndërtesa e “Fakulteteve Teknike”, 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +383 38 554 899

URL: <https://fin.uni-pr.edu>

e-mail: fin@uni-pr.edu

Ref. nr. _____

Prishtinë ____/____/____

Komisioni për vlerësimin e punimit të diplomës master me titull “Modelimi hidraulik i vërshimeve në lumin Klina” të kandidatit Bledar Hajdari, bachelor i ndërtimtarisë, drejtimi Hidroteknike, konstaton se punimi i dorëzuar i plotëson kushtet të parapara në Ligjin mbi Arsimin e Lartë dhe Rregulloren për studime Master të Universitetit të Prishtinës, prandaj edhe i propozon Këshillit të Fakultetit të Inxhinierise se Ndërtimit që të aprovojë këtë raport dhe të vazhdojë me procedurën e mëtejme për mbrojtje publike te temës së diplomës master.

03/11/2023

Komisioni Vlerësues:

1. *Prof.asoc.Dr. Figene Ahmedi*

/ kryetar/

2. *Prof. Dr. Laura Kusari*

/ mentor/

3. *Prof..Asis. Dr. Lavdim*

Osmanaj

/ anëtar/

P.S. Sipas rregullores nr. 1/334 të datës 31 maj 2023, për studime Master, nenë 11, alineja 5, Raporti i Vlerësimit duhet të hartohet në afat prej 15 ditëve, i nënshtuar nga tre anëtarët e komisionit vlerësues, dorëzohet dhe protokollohet tek arkiva e FIN.

Pranuar me: 3/10/2023			
Nj.org.	Numër	Shtojca	Vlera
06	2847/4	—	—

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është analiza e vërshimeve që po ndodhin në komunën e Skënderajit dhe masat që duhet të ndërmerren më qëllim të zbutjes së dëmeve nga vërshimet.

Qysh në kohët e lashta, shoqëritë njerëzore kanë qenë të ekspozuara nga rreziku i fenomeneve natyrore siç janë tërmetet, vullkanet apo edhe vërshimet, të cilat edhe në kohët e sotme duke marrë parasysh teknologjinë moderne, nuk mund të shmangen tërësisht.

Vërshimet kanë potencialin të shkaktojnë dëme të konsiderueshme në infrastrukturë, pronësi, dhe mjedis, si dhe paraqesin një kërcënim për jetën e njerëzve.

Për punimin e këtij hulumtimi së pari jam bazuar në literaturë të huaj dhe hulumtime ku kam përshkruar në përgjithësi kuptimin mbi lumenjtë, reshjet dhe matjet e tyre, matjet hidrometrike, informatat mbi komunën e Skënderajit, në të cilën përfshihen pozita gjeografike, karakteristikat morfologjike, klimatike dhe hidrologjike si dhe në fund kam arritur të pjesa e modelimit hidraulik të lumit Klina.

Së pari janë bërë matjet gjeodezike të pellgut dhe shtratit të lumit dhe është krijuar sipërfaqja gjeodezike prej së cilës është bërë modeli hidraulik. Sipërfaqja e pikave gjeodezike për këtë segment të lumit Klina është $A = 77.55$ ha.

Shtrati i segmentit të trajtuar ka gjatësi $L=745.31$ m dhe është i rregulluar përgjatë tërë gjatësisë dhe ka formë trapezi me dimensione ($B_1=4.00$ m, $B_2=9.50$ m dhe $H=2.00$ m) për stacionazhat S38-S48, ndërsa prej stacionazhave S1-S37, dimensionet janë ($B_1=6.00$ m, $B_2=10.00$ m dhe $H=2.00$ m). Fundi i shtratit të lumit është në gjendje natyrore.

Profilat tërthore janë të vendosura në distancë mesatare nga njëra tjetra 20 m.

Për modelim të sipërfaqeve vërshuese, së pari janë llogaritur prurjet maksimale shumëvjeçare ku si bazë i kemi marrë prurjen maksimale 20 vjeçare $Q_{maks}^{20} = 48$ m³/s, prurjen maksimale 50 vjeçare $Q_{maks}^{50} = 85$ m³/s, prurjen maksimale 100 vjeçare $Q_{maks}^{100} = 110$ m³/s dhe prurjen maksimale 100 vjeçare+faktori ekologjik $Q_{maks}^{100} = 180$ m³/s.

Prurja mesatare e lumit është $Q_{mes} = 2.08$ m³/s, prurja ekologjike vegetative është $Q_{ek} = 0.048$ m³/s dhe prurja ekologjike ekstravegetative është $Q_{ek} = 0.032$ m³/s.

Prurja ekologjike vegetative është mjaft e ulët, vetëm 2.30 % e prurjes mesatare. Për vazhdim të jetës bimore dhe shtazore, prurja ekologjike vegetative, duhet të jetë të paktën 0.2 m³/s, apo rreth 10 % e prurjes mesatare.

Këto prurje janë futur në HEC-RAS dhe pas modelimit hidraulik është parë se vërshimet ndodhin në të dy anët e lumit, si pasojë e shtratit tërthor i cili nuk i përballon asnjërën nga prurjet maksimale. Sipërfaqe më e madhe e vërshimeve ndodh në anën e djathtë të kahjes së rrjedhjes.

Në anën e djathtë të kahjes së rrjedhjes së lumit, kryesisht gjenden objekte afariste dhe objekte tjera të veçanta, ndërsa në anën e majtë kryesisht gjenden shtëpi banimi.

Kemi arritur në përfundime se mbrojtja nga vërshimet për komunën e Skënderajit nga vërshimet e lumit Klina, është ende e vogël sepse shtrati ekzistues i rregulluar nuk mund të përballojë prurjet maksimale 20, 50 dhe 100 vjeçare.

Me qëllim të zbutjes së vërshimeve duhet të bëhen matje të vazhdueshme shumëvjeçare, në mënyrë që të bëhen analiza më të sakta për mbrojtjen ndaj vërshimeve, duhet të bëhet ndërtimi i argjinaturave sekondare në tërë gjatësinë e segmentit të trajtuar, pasi që shtrati aktual i rregulluar nuk ka aftësi të përballojë prurjet maksimale, mirëmbajtja e vazhdueshme e rrjetit të kanalizimit atmosferik të qytetit të Skënderajit dhe të mos hidhen mbeturina në shtrat të lumit.

Fjalët kyçe: vërshimet, lumi Klina, Pellgu i lumit Klina, prurjet, modelimi hidraulik, matjet hidrometrike.

Pranuar me: 31.10.2017			
Nj org.	Numër	Shtojca	Vlera
06	28471	—	—

Abstract

The purpose of this paper is to analyze the floods occurring in the municipality of Skënderaj and the measures that need to be taken to mitigate the damages caused by floods.

Since ancient times, human societies have been exposed to the risk of natural phenomena such as earthquakes, volcanoes, and floods. Even in modern times, with advanced technology, it is impossible to completely avoid these natural disasters. Floods have the potential to cause significant damage to infrastructure, property, and the environment, posing a threat to human life. For the research in this paper, I first relied on foreign literature and studies, describing the general meaning of rivers, rainfall, and their measurements, hydrometric measurements, information about the municipality of Skënderaj, including its geographical position, morphological, climatic, and hydrological characteristics. Finally, I reached the hydraulic modeling part of the Klina river.

Firstly, geodetic measurements of the riverbed were made, and a geodetic surface was created for hydraulic modeling. The geodetic points' surface for this segment of the Klina river is $A = 77.55$ hectares. The treated segment's riverbed has a length $L = 745.31$ meters and is regulated along its entire length, having a trapezoidal shape with dimensions ($B1 = 4.00$ meters, $B2 = 9.50$ meters, and $H = 2.00$ meters) for stations S38-S48, while for stations S1-S37, the dimensions are ($B1 = 6.00$ meters, $B2 = 10.00$ meters, and $H = 2.00$ meters). The end of the riverbed is in a natural state. Circular profiles are placed at an average distance of 20 meters from each other.

For modeling the flood surfaces, maximum multi-year inflows were first calculated, taking as a basis the maximum 20-year inflow $Q_{maks20} = 48$ m³/s, the maximum 50-year inflow $Q_{maks50} = 85$ m³/s, the maximum 100-year inflow $Q_{maks100} = 110$ m³/s, and the maximum 100-year inflow plus the ecological factor $Q_{maks100} = 180$ m³/s. The average flow of the river is $Q_{mes} = 2.08$ m³/s, the vegetative ecological flow is $Q_{ek} = 0.048$ m³/s, and the extravegetative ecological flow is $Q_{ek} = 0.032$ m³/s.

The vegetative ecological flow is quite low, only 2.30% of the average flow. For the continuity of plant and animal life, the vegetative ecological flow should be at least 0.2 m³/s, or about 10% of the average flow. These inflows were entered into HEC-RAS, and after hydraulic modeling, it was observed that floods occur on both sides of the river as a result of the circular riverbed not accommodating any of the maximum inflows. The larger flood area occurs on the right side of the flow.

On the right side of the river flow, mainly commercial objects and other specific objects are located, while on the left side, residential houses are mainly found. It is concluded that flood protection for the municipality of Skënderaj from Klina river floods is still inadequate because the existing regulated riverbed cannot handle the maximum 20, 50, and 100-year inflows. To mitigate floods, continuous multi-year measurements should be made for more accurate flood protection analysis. The construction of secondary embankments along the entire length of the treated segment is necessary because the current regulated riverbed cannot handle the maximum inflows, continuous maintenance of the atmospheric drainage network of the city of Skënderaj and avoiding waste disposal in the riverbed are also essential.

Keywords: floods, river of Klina, river basin of Klina, flows, hydraulic modeling, streamflow measurement.

UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI I NDËRTIMTARISË
PROGRAMI STUDIMOR: HIDROTEKNIKË
NIVELI I STUDIMEVE: MASTER



PUNIM DIPLOME - MASTER

Modelimi hidraulik i vërshimeve në lumin Klina

Mentor:

Prof.dr. Laura KUSARI

Kandidati:

Bledar HAJDARI

Prishtinë 2023

PËRMBAJTJA

1. Hyrje.....	13
1.1 Qëllimi i hulumtimit	13
1.1.1 Pyetjet hulumtuese	13
1.2 Metodologjia dhe metodat	14
1.3 Struktura e punimit.....	14
2. Hulumtimi i literaturës.....	15
2.1 Definicioni mbi lumenjtë.....	18
2.1.1 Hidrografia e Kosovës.....	18
2.1.2 Pellgu.....	20
2.1.3 Karakteristikat kryesore të lumenjve	23
2.1.4 Hidraulika e lumenjve.....	27
2.1.5 Sedimentet	31
2.2 Reshjet	32
2.2.1 Cikli hidrologjik.....	33
2.2.2 Ekuacioni i bilancit uJOR	34
2.2.3 Metodot e matjes së reshjeve	34
2.2.4 Matja e reshjeve	36
2.3 Matjet hidrometrike	38
2.3.1 Vendmatjet hidrometrike.....	38
2.3.2 Instrumentet matëse	39
2.3.3 Matja e shpejtësisë	40
2.4 Vërshimet.....	44
2.4.1 Masat për mbrojtje nga vërshimet	47
2.4.2 Analiza e frekuencës hidrologjike	49
2.4.3 Vlerësimi i rrezikut nga vërshimet	49
2.5 Pozita gjeografike e Skënderajit	50
3. Modelimi i lumit Klina.....	55
3.1 Informata mbi lumin Klina.....	55
3.2 Gjendja ekzistuese e lumit Klina	56
3.3 Llogaritjet hidrologjike	57
3.4 Modelimi hidraulik i lumit Klina.....	57
3.4.1 Situacioni	59

3.4.2	Profili gjatësor	59
3.4.3	Profilet tërthore	60
3.4.4	Hapësira e përbytur nga vërshimet	60
4.	Rezultatet dhe Diskutimet	70
4.1	Rezultatet	70
4.2	Diskutimet	71
5.	Përfundimet dhe Rekomandimet.....	72
5.1	Përfundimet.....	72
5.2	Rekomandimet	72
Anekset	74
Aneksi 1.	Matjet gjeodezike të pellgut të lumit	74
Aneksi 2.	Koordinatat e aksit të lumit.....	110
Aneksi 3.	Hidrologjia	111
Referencat	112

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Rrjeti hidrografik i lumenjve të Kosovës.....	19
Figura 2. Hidrografi i rrjedhjes në funksion të rënies së pellgut	20
Figura 3. Format kryesore të pellgjeve	21
Figura 4. Format e pellgut	22
Figura 5. Profili tërthor i lumit	23
Figura 6. Prerja gjatësore e rrjedhjes së lumit	24
Figura 7. Profili gjatësor i lumit dhe profilet tërthore në varësi të rënies gjatësore	25
Figura 8. Rrjedhja e ujit në lum meandruës	26
Figura 9. Parametrat e përshkrimit të meandrës	26
Figura 10. Paraqitja grafike e rrjedhjes në kanale të hapura	28
Figura 11. Prerja tërthore e një kanali të hapur	28
Figura 12. Prerjet tërthore të kanaleve të hapura dhe elementet gjeometrike të tyre	29
Figura 13. Energjia specifike	30
Figura 14. Thellësia normale e rrjedhjes	30
Figura 15. Format e shtratit të lumit në varësi të terrenit	31
Figura 16. Gjendja e ndryshme e sedimenteve	32
Figura 17. Cikli hidrologjik	34
Figura 18. Metoda e Thiessen-it	35
Figura 19. Metoda e izohjeteve	36
Figura 20. Instrumenti i Simons-it.....	36
Figura 21. Regjistruesi automatik i reshjeve.....	37
Figura 22. Vlerat mesatare historike të reshjeve	37
Figura 23. Matjet hidrometrike me latë	40
Figura 24. Shpërndarja e shpejtësisë sipas thellësisë	41
Figura 25. Metoda e sipërfaqeve – shpejtësive	42
Figura 26. Matësi me aks vertikal	43
Figura 27. Matësi me aks horizontal	44
Figura 28. Nivelet e ujit në lum dhe vërshimet nga ujërat e mëdha	44
Figura 29. Ndikimi i urbanizimit në ciklin hidrologjik	45
Figura 30. Vërshimet nga pendat	46
Figura 31. Vërshimet në komunën e Skënderajit.....	47
Figura 32. Situacioni i lumit Klina	55
Figura 33. Gjendja ekzistuese e lumit Klina sipas fotografive të shkrepura	56
Figura 34. Profili tërthor për stacionazhat S38-S48	56
Figura 35. Profilet tërthore për stacionazhat S1-S37	57
Figura 36. Modeli digjital i pellgut të lumit.....	58
Figura 37. Situacioni pa ortofoto i lumit Klina	59
Figura 38. Profili gjatësor i lumit Klina.....	59
Figura 39. Profili tërthor i lumit i paraqitur me HEC-RAS	60
Figura 40. Paraqitja XYZ e vërshimeve të lumit Klina	61
Figura 41. Vërshimet nga prurjet maksimale 20 vjeçare	61
Figura 42. Vërshimet nga prurjet maksimale 50 vjeçare	62
Figura 43. Vërshimet nga prurjet maksimale 100 vjeçare	62

Figura 44. Vërshimet nga prurjet maksimale 100 vjeçare+faktori ekologjik 63
Figura 45. Lakorja e prurjeve maksimale Q (T) 70

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Gjatësia dhe sipërfaqja e lumenjve dhe pellgjeve të Kosovës	19
Tabela 2: Lista e lumenjve më të gjatë në botë	24
Tabela 3. Koeficienti i Manning-ut për materialet e ndryshme	27
Tabela 4. Forma tabelare e parametrave hidraulik të modelimit të lumit Klina	63
Tabela 5. Paraqitja tabelare e prurjeve maksimale ndër vite	70
Tabela 6. Paraqitja tabelare e matjeve gjeodezike të pellgut të lumit.....	74
Tabela 7. Koordinatat e aksit të lumit Klina	110
Tabela 8. Vlerat mesatare vjetore te reshjeve sipas muajve të vitit 1948-1978	111

DEKLARATË PËR PUNË ORIGJINALE

Unë, Studenti-ja *Bsc. Bledar Hajdari* me Nr. ID-së studentore 190602200007.

Deklaroj me përgjegjësi të plotë se ky punim nuk është prezantuar për vlerësim apo botuar më parë, pjesërisht apo në tërësi pranë këtij apo ndonjë Institucioni të Lartë Arsimit tjetër.

Punimi i diplomës master me titull:

<i>MODELIMI HIDRAULIK I VËRSHIMEVE NË LUMIN KLINA</i>

- a) Është punë origjinale dhe është punuar tërësisht nga unë;
- b) Nuk është marrë nga studentë të tjerë apo nga punime tjera nga Universiteti i Prishtinës, ose nga ndonjë Institucion i Lartë Arsimit;
- c) Nuk është kopje e ndonjë punimi të marrë në internet apo në bibliotekë;
- d) Nuk përmban modifikime të dhënash, duke i paraqitur ato si kontribut origjinal;
- e) I respekton të gjitha kërkesat për të drejtat e autorit, duke i saktësuar dhe cituar të gjitha kontributet nga burime të tjera.

Dëshmoj se jam vënë në dijeni që vërtetimi ndryshe i të dhënave të deklaruara më sipër do të rezultojë me zhvlerësimin e punimit dhe tërheqjen e titullit të fituar.

Studenti/nënshkrimi

<i>Bsc. Bledar Hajdari</i>

Abstrakt

Qëllimi i këtij punimi është analiza e vërshimeve që po ndodhin në komunën e Skënderajit dhe masat që duhet të ndërmerren më qëllim të zbutjes së dëmeve nga vërshimet.

Qysh në kohët e lashta, shoqëritë njerëzore kanë qenë të ekspozuara nga rreziku i fenomeneve natyrore siç janë tërmetet, vullkanet apo edhe vërshimet, të cilat edhe në kohët e sotme duke marrë parasysh teknologjinë moderne, nuk mund të shmangen tërësisht.

Vërshimet kanë potencialin të shkaktojnë dëme të konsiderueshme në infrastrukturë, pronësi, dhe mjedis, si dhe paraqesin një kërcënim për jetën e njerëzve.

Për punimin e këtij hulumtimi së pari jam bazuar në literaturë të huaj dhe hulumtime ku kam përshkruar në përgjithësi kuptimin mbi lumenjtë, reshjet dhe matjet e tyre, matjet hidrometrike, informatat mbi komunën e Skënderajit, në të cilën përfshihen pozita gjeografike, karakteristikat morfologjike, klimatike dhe hidrologjike si dhe në fund kam arritur te pjesa e modelimit hidraulik të lumit Klina.

Së pari janë bërë matjet gjeodezike të pellgut dhe shtratit të lumit dhe është krijuar sipërfaqja gjeodezike prej së cilës është bërë modeli hidraulik. Sipërfaqja e pikave gjeodezike për këtë segment të lumit Klina është $A = 77.55$ ha.

Shtrati i segmentit të trajtuar ka gjatësi $L=745.31$ m dhe është i rregulluar përgjatë tërë gjatësisë dhe ka formë trapezi me dimensione ($B_1=4.00$ m, $B_2=9.50$ m dhe $H=2.00$ m) për stacionazhat S38-S48, ndërsa prej stacionazhave S1-S37, dimensionet janë ($B_1=6.00$ m, $B_2=10.00$ m dhe $H=2.00$ m). Fundi i shtratit të lumit është në gjendje natyrore.

Profilet tërthore janë të vendosura në distancë mesatare nga njëra tjetra 20 m.

Për modelim të sipërfaqeve vërshuese, së pari janë llogaritur prurjet maksimale shumëvjeçare ku si bazë i kemi marrë prurjen maksimale 20 vjeçare $Q_{maks}^{20} = 48$ m³/s, prurjen maksimale 50 vjeçare $Q_{maks}^{50} = 85$ m³/s, prurjen maksimale 100 vjeçare $Q_{maks}^{100} = 110$ m³/s dhe prurjen maksimale 100 vjeçare+faktori ekologjik $Q_{maks}^{100} = 180$ m³/s.

Prurja mesatare e lumit është $Q_{mes} = 2.08$ m³/s, prurja ekologjike vegjetative është $Q_{ek} = 0.048$ m³/s dhe prurja ekologjike ekstravegetative është $Q_{ek} = 0.032$ m³/s.

Prurja ekologjike vegjetative është mjaft e ulët, vetëm 2.30 % e prurjes mesatare. Për vazhdim të jetës bimore dhe shtazore, prurja ekologjike vegjetative, duhet të jetë të paktën 0.2 m³/s, apo rreth 10 % e prurjes mesatare.

Këto prurje janë futur në HEC-RAS dhe pas modelimit hidraulik është parë se vërshimet ndodhin në të dy anët e lumit, si pasojë e shtratit tërthor i cili nuk i përballon asnjërën nga prurjet maksimale. Sipërfaqe më e madhe e vërshimeve ndodh në anën e djathtë të kahjes së rrjedhjes.

Në anën e djathtë të kahjes së rrjedhjes së lumit, kryesisht gjenden objekte afariste dhe objekte tjera të veçanta, ndërsa në anën e majtë kryesisht gjenden shtëpi banimi.

Kemi arritur në përfundime se mbrojtja nga vërshimet për komunën e Skënderajit nga vërshimet e lumit Klina, është ende e vogël sepse shtrati ekzistues i rregulluar nuk mund të përballojë prurjet maksimale 20, 50 dhe 100 vjeçare.

Me qëllim të zbutjes së vërshimeve duhet të bëhen matje të vazhdueshme shumëvjeçare, në mënyrë që të bëhen analiza më të sakta për mbrojtjen ndaj vërshimeve, duhet të bëhet ndërtimi i argjinaturave sekondare në tërë gjatësinë e segmentit të trajtuar, pasi që shtrati aktual i rregulluar nuk ka aftësi të përballojë prurjet maksimale, mirëmbajtja e vazhdueshme e rrjetit të kanalizimit atmosferik të qytetit të Skënderajit dhe të mos hidhen mbeturina në shtrat të lumit.

Fjalët kyçe: vërshimet, lumi Klina, Pellgu i lumit Klina, prurjet, modelimi hidraulik, matjet hidrometrike.

Abstract

The purpose of this paper is to analyze the floods occurring in the municipality of Skënderaj and the measures that need to be taken to mitigate the damages caused by floods.

Since ancient times, human societies have been exposed to the risk of natural phenomena such as earthquakes, volcanoes, and floods. Even in modern times, with advanced technology, it is impossible to completely avoid these natural disasters. Floods have the potential to cause significant damage to infrastructure, property, and the environment, posing a threat to human life. For the research in this paper, I first relied on foreign literature and studies, describing the general meaning of rivers, rainfall, and their measurements, hydrometric measurements, information about the municipality of Skënderaj, including its geographical position, morphological, climatic, and hydrological characteristics. Finally, I reached the hydraulic modeling part of the Klina river.

Firstly, geodetic measurements of the riverbed were made, and a geodetic surface was created for hydraulic modeling. The geodetic points' surface for this segment of the Klina river is $A = 77.55$ hectares. The treated segment's riverbed has a length $L = 745.31$ meters and is regulated along its entire length, having a trapezoidal shape with dimensions ($B_1 = 4.00$ meters, $B_2 = 9.50$ meters, and $H = 2.00$ meters) for stations S38-S48, while for stations S1-S37, the dimensions are ($B_1 = 6.00$ meters, $B_2 = 10.00$ meters, and $H = 2.00$ meters). The end of the riverbed is in a natural state. Circular profiles are placed at an average distance of 20 meters from each other.

For modeling the flood surfaces, maximum multi-year inflows were first calculated, taking as a basis the maximum 20-year inflow $Q_{maks20} = 48$ m³/s, the maximum 50-year inflow $Q_{maks50} = 85$ m³/s, the maximum 100-year inflow $Q_{maks100} = 110$ m³/s, and the maximum 100-year inflow plus the ecological factor $Q_{maks100} = 180$ m³/s. The average flow of the river is $Q_{mes} = 2.08$ m³/s, the vegetative ecological flow is $Q_{ek} = 0.048$ m³/s, and the extravegetative ecological flow is $Q_{ek} = 0.032$ m³/s.

The vegetative ecological flow is quite low, only 2.30% of the average flow. For the continuity of plant and animal life, the vegetative ecological flow should be at least 0.2 m³/s, or about 10% of the average flow. These inflows were entered into HEC-RAS, and after hydraulic modeling, it was observed that floods occur on both sides of the river as a result of the circular riverbed not accommodating any of the maximum inflows. The larger flood area occurs on the right side of the flow.

On the right side of the river flow, mainly commercial objects and other specific objects are located, while on the left side, residential houses are mainly found. It is concluded that flood protection for the municipality of Skënderaj from Klina river floods is still inadequate because the existing regulated riverbed cannot handle the maximum 20, 50, and 100-year inflows. To mitigate floods, continuous multi-year measurements should be made for more accurate flood protection analysis. The construction of secondary embankments along the entire length of the treated segment is necessary because the current regulated riverbed cannot handle the maximum inflows, continuous maintenance of the atmospheric drainage network of the city of Skënderaj and avoiding waste disposal in the riverbed are also essential.

Keywords: floods, river of Klina, river basin of Klina, flows, hydraulic modeling, streamflow measurement.

Falënderimet

Për realizimin e kësaj teme të diplomës, së pari falënderoj mentorin tim të temës së masterit prof. dr Laura Kusari dhe prof. dr Lavdim Osmanaj që më kanë ndihmuar jashtëzakonisht shumë.

Pastaj falënderoj familjen time, të cilët më qëndruan pranë në çdo sfidë të jetës sime dhe ishin kontribuesit kryesor në shkollimin tim.

Falenderoj profesorët të cilët më përgaditën profesionalisht gjatë këtyre viteve të studimeve.

Në fund i falënderoj shoqërinë dhe kolegët e mi të cilët në asnjë moment nuk hezituan të më ndihmojnë përgjatë këtij rrugëtimi.

1. Hyrje

Vërshimet janë ngjarje ekstreme që ndodhin si pasojë e intensitetit të lartë të reshjeve, ku sasia e ujit nga reshjet e tejkalon aftësinë mbajtëse të tokës apo objekteve artificiale të ndërtuara nga dora e njeriut.

Qysh në kohët e lashta, shoqëritë njerëzore kanë qenë të ekspozuara nga rreziku i fenomeneve natyrore siç janë tërmetet, vullkanet apo edhe vërshimet, të cilat edhe në kohët e sotme duke marrë parasysh teknologjinë moderne, nuk mund të shmangen tërësisht.

Vërshimet kanë potencialin të shkaktojnë dëme të konsiderueshme në infrastrukturë, pronësi, dhe mjedis, si dhe paraqesin një kërcënim për jetën e njerëzve. Madhësia e një vërshimit varet nga shumë faktorë, si vëllimi dhe shpejtësia e ujit, koha e zgjatjes së ngjarjes dhe ndjeshmëria e zonës së prekur.

Ndikimet e vërshimeve mund të jenë shkatërrimtare. Ato mund të çojnë në shkatërrimin e ndërtesave, rrugëve, urave, dhe infrastrukturës tjetër. Ujërat e mëdha mund të kontaminojnë burimet e ujit, duke shkaktuar rrezikun e sëmundjeve të përcjellura me ujë. Ato mund gjithashtu të shkaktojnë erozion të tokës, dëmtim të kulturave bujqësore, dhe ndërprerje të ekosistemeve. Në zonat e banuara, inundacionet mund të zhvendosin njerëzit nga shtëpitë e tyre, duke shkaktuar zhvendosje të përkohshme ose të zgjatur dhe nevojën për përpjekje të emergjencës.

1.1 Qëllimi i hulumtimit

Arsyeja e këtij hulumtimi është bërja e një analize e cila do të ndihmojë në kuptimin e vërshimeve në komunën e Skënderajit dhe mbrojtjen nga ujërat e mëdha të cilat dita ditës po shkaktojnë dëme të mëdha ekonomike.

1.1.1 Pyetjet hulumtuese

1. Qyteti i Skënderajit a është i rrezikuar nga vërshimet?
2. Analiza e prurjeve hidrologjike ndër vite dhe niveli i vërshimit për prurjet hidrologjike të ndryshme?
3. Modelimi i përmbytjeve të lumit Klina për prurje hidrologjike të ndryshme?

1.2 Metodologjia dhe metodat

Për t'a punuar këtë temë, së pari është bërë hulumtimi në literaturë ku si bazë studimi janë marrë libra dhe publikime të ngjashme, pastaj janë bërë matjet gjeodezike në terren të pellgut të lumit Klina në komunën e Skënderajit, për segmentin e trajtuar.

Pjesa tekstuale e kësaj teme është punuar me programet kompjuterike si Word dhe Excel, ndërsa pjesa grafike ku përfshihen matjet gjeodezike dhe modelet e përmbytjeve janë punuar me programet inxhinierike siç janë Civil 3D dhe HEC-RAS.

Metodat që janë përdorur në këtë punim janë: metoda e gjeneralizimit, metoda e hulumtimit, metoda e përshkrimit, metoda historike, metoda matematikore, metoda statistikore, metoda empirike, metoda e modelimit, metoda e analizës dhe metoda e matjeve.

1.3 Struktura e punimit

Punimi është organizuar në 5 kapituj:

1. Kapitulli 1 përmban pjesën hyrëse të temës që trajtohet, qëllimin e hulumtimit dhe metodologjinë e përdorur;
2. Kapitulli 2 përmban hulumtimin e literaturës, ku shtjellohen lumenjtë, matjet hidrometrike, reshjet dhe vërshimet në përgjithësi;
3. Kapitulli 3 përmban modelimin e lumit Klina, ku janë bërë llogaritjet hidrologjike të prurjeve të lumit me metodat statistikore për përcaktimin e prurjeve maksimale shumëvjeçare, pastaj për ato prurje është bërë modeli hidraulik i vërshimeve për segmentin e trajtuar dhe në fund janë paraqitur masat mbrojtëse nga këto vërshime.
4. Kapitulli 4 përmban rezultatet dhe diskutimet, ku janë dhënë përgjigjet e pyetjeve hulumtuese dhe janë diskutuar ato rezultate.
5. Kapitulli 5 përmban përfundimet dhe rekomandimet.

2. Hulumtimi i literaturës

Për realizimin e punimit tim të diplomës për modelimin hidraulik të lumit Klina në qytetin e Skënderajit, jam bazuar në literaturën shqiptare, të huaj dhe në publikime, ku disa fusha të studimit i kam përmendur në vijim:

Studimi i modelimit të përmytjeve dhe hartimit të zonave të përmytura u krye për luginën e lumit Meenachil në Keralë. Studimi tregon përdorimin e programeve kompjuterike HEC-RAS dhe HEC-HMS për të përcaktuar rrezikun dhe vulnerabilitetin nga përmytjet. Hartat e zonave të përmytura për periudha të ndryshme të rikthimit u zhvilluan për të analizuar skenarët e përmytjeve të ardhshme. Shiu i rëndë i në korrik-gusht 2018, shkaktoi përmytje të rënda, shkaktoi humbjen e shumë jetëve dhe dëme materiale në Keralë. Ky studim gjithashtu analizoi ngjarjen e përmytjes në vitin 2018 për të zhvilluar hartat e zonave të përmytura dhe për të identifikuar zonat e prekura nga përmytja të ndryshme sipas klasave të përdorimit të tokës, si dhe infrastrukturën rrugore e prekur nga përmytja. Luginës së lumit Meenachil iu dha një kufi duke përdorur HEC-HMS dhe karakteristikat topografike u nxorrën nga SRTM DEM. Modeli hidrologjik u zhvillua duke përdorur metodën e numrit të kthesëve SCS, metodën e hidrografit të njësisë SCS dhe metodën Muskingum për metodën e humbjes, transformimit dhe rrugëtimit, respektivisht. Modeli hidrologjik i simuluar u kalibrua manualisht duke përdorur të dhënat e rrjedhjes. Të dhënat e reshjeve nga viti 1990 deri në 2017 u përdorën për të ekzekutuar simulimin hidrologjik për të marrë vlerat e rrjedhjes që u përdorën si input për analizën hidraulike duke përdorur HEC-RAS. Vlerat e rrjedhjes së marrë përdoren pastaj për të gjetur rrjedhjen maksimale për periudhat e rikthimit të ndryshme të 5, 10, 50, 100 dhe 500 viteve duke përdorur metodën e Gumbel-it. Prurja e simuluar përcillet tek HEC-RAS si kushti i sipërm për të identifikuar zonën e prekur nga përmytja. U realizua një analizë e qëndrueshmërisë në një dimension për të marrë thellësinë e përmytjes për periudha të ndryshme të rikthimit. Po ashtu, u krye një analizë hidraulike për vitin 2018. Prurja vjetore maksimale në Cumec u llogarit duke përdorur metodën e Gumbel-it dhe u gjet të jetë 7484.468 m³/s. Harta e fushës së përmytjes mbuloi një sipërfaqe prej 24.2465 km². U vërejt se thellësia e rrjedhjes u rrit në drejtim të pjesës së poshtme. Harta e zhvilluar e zonave të përmytura u vënë mbi hartën e rrugëve për të gjetur gjatësinë e rrugëve të klasave të ndryshme që u përmytën. Harta e përdorimit të tokës u krijua për vitin 2018 përmes metodës Isocluster të klasifikimit të papërcaktuar të imazhit LISS III. Kjo u përdor për të

identifikuar zonën e klasave të ndryshme të përdorimit të tokës që u prekën gjatë përmbytjes në vitin 2018 sipas simulimit. (Athira, Katpatal & Londhe, 2023)

Ky punim ilustron rëndësinë e përmbytjeve të lumenjve në zonat urbane, të cilat shkaktojnë humbjen e jetëve dhe dëme në pronë. Njohja e reagimit të pellgut të lumit ndaj ngjarjeve të reshjeve është jetike në praktikën inxhinierike për planifikimin dhe zhvillimin urban. Parashikimi i hartës së rrezikut nga përmbytjet është një kombinim i modelimit hidrologjik, modelimit hidraulik dhe vizualizimit të përmbytjeve lumi përmes SIG. Studimi i rastit për këtë kërkim është Sungai Kayu Ara që ndodhet në Damansara, Kuala Lumpur. Gjithsej u identifikuan 36 skenarë për të vlerësuar efektet e madhësisë së reshjeve (20 vjet, 50 vjet dhe 100 vjet ARI) dhe kohëzgjatjen (60, 120, 180 dhe 360 minuta) për kushtet ekzistuese, ndërmjetme dhe përfundimtare të zhvillimit. Rezultatet e simulimit të modelit hidrologjik treguan se një rritje në madhësinë e reshjeve çon në rritje të vëllimit të rrjedhjes dhe shpërthimit të rrjedhjes, ndërsa rritja e kohës së reshjeve rrit vëllimin e rrjedhjes, por zvogëlon shpërthimin e rrjedhjes së rrjedhjes. Për më tepër, kushtet përfundimtare të zhvillimit të luginës së lumit (90% papërmeueshmëri) gjenerojnë vëllim më të lartë rrjedhje dhe shpërthim të rrjedhjes krahasuar me kushtet ekzistuese dhe ndërmjetme të zhvillimit. Hartat e rrezikut nga përmbytjet e lumenjve gjenerohen në bazë të thellësisë së ujit, shpejtësisë së rrjedhjes dhe kombinimit të thellësisë së ujit dhe shpejtësisë së rrjedhjes. Këto harta tregojnë se ndikimi i thellësisë së ujit është më i rëndësishëm se shpejtësia e rrjedhjes gjatë përmbytjes së lumit. Prandaj, rreziku i lidhur me thellësinë e ujit është më i rëndësishëm në krahasim me shpejtësinë e rrjedhjes. Hartat e rrezikut nga përmbytjet e lumenjve janë baza e parashikimit të rrezikut nga përmbytjet e lumenjve.

Azagra-Camino (1999) fokusohet në një zonë studimi më të vogël duke përdorur të dhëna më të sakta të terrenit nga zhvillimi i Triangulated Irregular Network (TIN) në ArcviewGIS. TIN u krijua nga fotografimi ajror, i cili rezultoi në një përshkrim të shumë të saktë të terrenit të zonës së studimit. Duke përdorur zgjerimin AVRas, Azagra-Camino (1999) nxori informacionin topografik nga TIN dhe e importoi si kanal dhe gjeometri rrjedhe për përdorim në modelin HEC-RAS. Rezultatet e vizualizimit të përmbytjeve ofruan harta të përmbytjeve të sakta 2D dhe 3D. Metoda e Azagra dhe Camino ishte e kufizuar në një rezultat në kohë për çdo ekzekutim të modelit HEC-RAS në gjendje të qëndrueshme, duke bërë procesin e zhvillimit të animacioneve të përmbytjeve të lodhshëm. Animacionet e krijuara kërkonin ekzekutime të shumta të modelit HEC-RAS dhe

importimin e të dhënave në TIN. Gjithashtu, Azagra-Camino (1999) nxori të dhënat e prerjeve në drejtim të drejtpërdrejtë nga modeli i terrenit. (Sina, 2009)

Bangladeshi ndodhet në pjesën e poshtme të pellgut të lumenjve Ganges, Brahmaputra dhe Meghna dhe i cili është i ndjeshëm ndaj sasisë së madhe të reshjeve atmosferike, duke rezultuar në shfrytëzimin e sasisë së madhe të ujit përmes Bangladeshit çdo vit. Kjo shfrytëzim i ujit, së bashku me shkaqe të ndryshme të tjera, shkakton përmbytje të shpeshta me dëme të rënda në të gjithë Bangladeshin. Prandaj, në kuadër të këtij studimi është zhvilluar një model matematik, i cili është në gjendje të simulojë zonën e përmbytjes së përmbytjeve të lumenjve kryesorë të Bangladeshit dhe fushat e tyre të lidhura me përmbytje. Zona e studimit është zgjedhur në bazë të lumenjve kryesorë siç janë Gangesi, Xhemuna, Padma dhe Meghna e Bangladeshit, së bashku me fushat e lidhura me përmbytje. Për analizë, është përdorur softueri i modelimit hidrodinamik dydimensional HEC-RAS 2D. Është përgatitur një rrjet gjerësore me anë të të dhënave të bathimetrisë të marrë nga Instituti i Modelimit të Ujit (IWM). Është marrë një DEM i zonës së përmbytjes me rezolutë 30.87 m nga USGS. Të dhënat hidrografike janë marrë nga BWDB. Është përgatitur një rrjet i kombinuar i bathymetrisë dhe topografisë duke përdorur softuerin ArcMap. Modeli HEC-RAS 2D është ndërtuar në bazë të të dhënave të kombinuara të bathymetrisë dhe topografisë së zonës së studimit dhe kushteve kufizuese të nevojshme. Kalibrimi dhe validimi i modelit është bërë në krahasim me nivelin e ujit të matur në Sengram (Gangesi), Sirajganj (Xhemuna), Mawa (Padma) dhe me shfrytëzimin e matjes së derdhjes në Mawa (Padma). Një hartë përmbytjeje për datën 2 Gusht 2016 është përgatitur në bazë të rezultateve të simulimit të modelit dhe është krahasuar në mënyrë sasinore me hartën e përmbytjes së atë ditës të përgatitur nga Qendra e Parashikimit dhe Paralajmërimi të Përmbytjeve (FFWC) e Bangladeshit, në bazë të të dhënave reale të përmbytjes. Krahasimi tregon një pajtim të mirë të zonës së simuluar të përmbytjes së modelit me atë të përgatitur nga FFWC. Parametrat e ndryshëm të përmbytjeve si thellësia, koha e mbërritjes etj. janë analizuar për vitin 2014 duke përdorur rezultatet e simulimeve të modelit. Rajoni i Manikganjit ishte rajoni më i prekur nga përmbytjet në bazë të zonës së përmbytjes me një përqindje përmbytjeje prej 47.73 % në 27 Gusht 2014, e fituar nga harta e përmbytjes së përgatitur nga simulimi i modelit (Islam& Rahman, 2020).

2.1 Definicioni mbi lumenjtë

Lumenjtë paraqesin rrjedha ujore të cilat mbledhin gjatë rrugës së tyre, ujëra të ndryshme dhe shkarkohen në liqene, dete apo oqeanë. Ata janë një pjesë e rëndësishme e ciklit hidrologjik të Tokës, duke luajtur një rol të rëndësishëm në qarkullimin e ujit dhe formimin e peizazheve.

Karakteristikë kryesore e tyre është gjatësia, e cila varet nga shumë faktorë të ndryshëm hidrologjik apo edhe relievor.

Lumenjtë zakonisht formohen nga mbledhja e ujit nga burime të ndryshme si shiu, burimet, shkërrirja e akullnajave ose ujërat nëntokësore. Ata mund të ndryshojnë në madhësi, duke u përhapur nga pellgjet e vogla deri te sistemet e lumenjve të gjërë që shtrihen nëpër disa vende.

Rrjedha e një lumi ndikohet nga faktorë si forma e pellgut, sasia e ujit që hyjnë në sistem, forma e shtratit tërthor të lumit dhe prania e pengesave si gurët ose bimësia.

Lumenjtë kanë qenë të rëndësishme për qytetërimet njerëzore përgjatë historisë, duke shërbyer si burim uji për pije, larje dhe transport. Ata gjithashtu luajnë një rol në formimin e sipërfaqeve pjellore pas përmytjeve dhe shpesh kanë qenë qendra të vendosjes dhe aktivitetit ekonomik njerëzor.

Lumenjtë shtrihen në pjesën më të ulët të pellgut ujëmbledhës.

Lumenjtë dallojnë nga njëri tjetri në bazë të shumë faktorëve, siç janë:

- Madhësia;
- Gjeometria;
- Materiali i fundit të lumit;
- Lloji i sedimenteve;
- Mosha e lumit, etj.

2.1.1 Hidrografia e Kosovës

Hidrografia e rrjedhave ujore të Kosovës ndahet në 4 pellgje lumore: Drini i Bardhë, Ibri, Morava e Binçës, dhe Lepenci.

Rrjedhat lumore të Kosovës derdhën në tre ujëmbledhës detarë: Deti i Zi, Deti Adriatik dhe Deti Egje. Lumenjtë kryesor të cilët i përkasin ujëmbledhësit të Detit të Zi janë: Ibri, Sitnica me degët; (Llapi, Drenica), dhe Morava e Binçës. Detit Adriatik i përkasin: Drini i Bardhë me degët (Lumëbardhi i Pejës, Lumëbardhi i Deçanit, Lumëbardhi i Prizrenit, Lumi i Klinës, Ereniku, Mirusha, Toplluha dhe Plava). Ndërsa lumi i Lepencit me degën kryesore (Nerodime) i përkasin

Detit Egje. Vija ujëndarëse (pellgje ujëmbledhëse), kanë rrjedhje në drejtime të ndryshme. Koeficienti rrjedhës sillet prej 3.93 l/sec/km² (Morava e Binçës) deri 42.46 l/sec/km² (Lumëbardhi i Deçanit).

Drini i Bardhë ka gjatësisë më të madhe në kilometra brenda territorit të Kosovës me 122 km, ndërsa Lumëbardhi i Prizrenit më të vogël me 31 km.

Tabela 1. Gjatësia dhe sipërfaqja e lumenjve dhe pellgjeve të Kosovës (Burimi: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Resurset_ujore_te_Kosoves.pdf)

Emërtimi	Gjatësia në km brenda territorit të Kosovës	Sipërfaqja km ²
Drini i Bardhë	122	4.622
Sitnica	90	2.873
Lumëbardhi i Pejës	62	424.9
Morava e Binçës	60	1.552
Lepenci	53	679.0
Ereniku	51	510.3
Ibri	42	1.155
Lumëbardhi i Prizrenit	31	262.6




Figura 1. Rrjeti hidrografik i lumenjve të Kosovës (Burimi: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Resurset_ujore_te_Kosoves.pdf)

2.1.2 Pellgu

Paraqet sipërfaqen në të reshjet shndërrohen në rrjedhje.

Kur bie shi ose shkrihet bora brenda pellgut lumor, uji rrjedh poshtë maleve, mblidhet në lumenj dhe burime. Këto rrjedha ujore bashkohen së bashku, duke formuar në fund lumin kryesor. Pastaj lumi vazhdon rrjedhën e tij derisa të arrijë në oqean, në liqen, ose lum tjetër. Pellgjet lumore janë të rëndësishme për ekosistemet dhe shoqëritë njerëzore. Ato sigurojnë ujë të freskët për pije, bujqësi, dhe përdorim industrial.

Pellgjet kanë forma dhe madhësi të ndryshme. Forma dhe struktura e pellgut varet nga shumë faktorë siç janë:

- Faza e zhvillimit;
- Pjerrtësia e pellgut;
- Tektonika;
- Struktura e dherave dhe vegjetacionit të pellgut, etj.

Pjerrtësia e pellgut ndikon në shpejtësinë e largimit të ujërave dhe paraqitjen e vërshimeve.

Sa më e madhe pjerrtësia e pellgut, aq më e shpejtë do të jetë koha e largimit të ujërave.

Në vijim janë paraqitur dy hidrografe që tregojnë se si ndikon pjerrtësia e pellgut në rrjedhjen e ujit.




Figura 2. Hidrografi i rrjedhjes në funksion të rënies së pellgut (Burimi: B.H)

Pjerrtësia e pellgut llogaritet me shprehjen: $i = \frac{\Delta h}{L}$ (%)

Pellgjet kanë katër forma kryesore. Ato janë:

- Dendritike;
- Kafazore;
- Drejtëkëndëshe;
- Këndore.




Figura 3. Format kryesore të pellgjeve (Burimi: B. H)

Forma e pellgut do të kontribuojë në shpejtësinë me të cilën rrjedhja e ujit arrin në një lum. Një pellg i gjatë e i hollë do të marrë më shumë kohë për t'u drenazhuar sesa një pellg në formë më rrethore.

Shprehet me formulën:

$$F = \frac{L^2}{A}$$

L – Gjatësia maksimale e pellgut

A – Sipërfaqja e rrethit, që fitohet nga diametri $D = L$




Figura 4. Format e pellgut (Burimi: B. H)

Mbulesa bimore dhe koeficienti i pyllëzimit të pellgut (kp)

Kjo përcakton kushtet e lëvizjes së ujit në sipërfaqe dhe në shtresën e sipërme të tokës si dhe humbjet në infiltrim, avullim dhe mbajtjen e një pjesë të reshjeve me anë të degëve e gjetheve. Koeficienti i pyllëzimit k_p del si raport i shumës së sipërfaqeve të mbuluara me pyll (Σf_p), me sipërfaqen (A) të pellgut dhe shprehet me formulën:

$$Kp = \frac{\Sigma f_p}{A} * 100\%$$

Ku,

Kp – Koeficienti i pyllëzimit të pellgut,

f_p – Sipërfaqet e pyllëzuara (km^2)

A – Sipërfaqja totale

Koeficienti i liqenizimit të pellgut (Kl)

Koeficienti i liqenizimit të pellgut llogaritet si raport i shumës së sipërfaqes ujore (f) në pellg, me sipërfaqen e pellgut (A) dhe shprehet në përqindje të saj. Formula që shpreh koeficientin e liqenizimit ka formën:

$$Kp = \frac{\Sigma fl}{A} * 100\%$$

Ku,

Kp – Koeficienti i pyllëzimit të pellgut,

fl – Sipërfaqet ujore të pellgut (km^2)

A – Sipërfaqja totale

2.1.3 Karakteristikat kryesore të lumenjve

Çdo lum i ka karakteristikat e veta. Për studim sa më të detajuar të lumit për nevoja të ndryshme, duhet të merren parasysh këta faktorë:

- **Rrjedhja:** Prerja tërthore, prurja dhe shpejtësia dhe turbulenca;
- **Gjeometria:** Gjatësia, gjerësia, profili gjatësor, forma e profilit tërthor dhe meandrimi;
- **Sedimentet:** Lloji i materialit të shtratit, erozioni dhe sedimentet;
- **Të tjera:** Kimia e ujit dhe bota bimore e shtazore.

Rrjedhja e ujit

Prurja e lumit paraqet vëllimin e ujit që rrjedh brenda një kohe të caktuar dhe shprehet në metër kub për sekond apo litra për sekond.

Llogaritet me shprehjet:

$$Q = \frac{V}{t} = \frac{\text{Vëllimi}}{\text{koha}} = \frac{\text{m}^3}{\text{s}}$$

$$Q = v * A = \text{Shpejtësia e rrjedhjes} \times \text{Sipërfaqja e prerjes tërthore} = \frac{\text{m}^3}{\text{s}}$$




Figura 5. Profili tërthor i lumit (Burimi: B. H)

Gjeometria e lumit

Gjatësia e lumit është parametri kryesor që i dallon lumenjtë nga liqenet apo detet për shkak se gjatësia e tij është shumë më e madhe në raport me dy dimensionet tjera siç janë gjerësia dhe thellësia.

Në vijim është paraqitur një tabelë me lumenjtë më të gjatë në botë:

Tabela 2: Lista e lumenjve më të gjatë në botë (Burimi: <https://www.worldatlas.com/rivers/the-10-longest-rivers-in-the-world.html>)

Lumi	Vendi	Gjatësia (km)
Nili	Afrikë	6650
Lumi Amazon	Amerikë e Jugut	6400
Lumi Yangtze	Kinë	6300
Lumi Mississippi	SHBA	6270
Lumi Yenisei	Rusi dhe Mongoli	5500
Lumi i Verdhë	Kinë	5464
Lumi Ob	Rusi	5410
Lumi Rio de la Plata	Argjentinë dhe Uruguaj	4880
Lumi Kongo	Afrikë	4700
Lumi Amur	Rusi	4444

Gjerësia dhe thellësia e lumit, paraqesin profilin tërthor të lumit, e cila është paraqitur në figurën e mësipërme.

Rënia gjatësore varet nga nga shumë faktorë siç janë burimi i lumit, pjerrtësia e pellgut, gjatësia e lumit, etj.

Në vijim kemi të paraqitur rënie gjatësore dhe tërthore për një lum për tërë gjatësinë e tij.




Figura 6. Prerja gjatësore e rrjedhjes së lumit (Burimi: B. H)




Figura 7. Profili gjatësor i lumit dhe profilet tërthore në varësi të rënies gjatësore (Burimi: B. H)

Profili gjatësor është një grafik i gjatësisë dhe lartësisë.

Një profil gjatësor është në funksion të:

- Prurjes;
- Sedimenteve;
- Rezistencës së shtratit të lumit;
- Gjerësisë;
- Thellësisë dhe
- Pjerrtësisë.

Meandrimi i lumit

Paraqet gjarpërimin e shtratis të lumit si pasojë e erozionit, sedimenteve dhe zhvendosjes së shtratis të lumit përgjatë kohës.

Zakonisht ndodh në segmentet me rënie gjatësore të vogël.

Në bazë të figurës së mëposhtme, vërejmë se gjatë rrjedhjes së ujit nëpër lum, do të shfaqen shpejtësitë më të mëdha të rrjedhjes, kah ana e jashtme e kthesës së lumit, duke shkaktuar erozion, ndërsa nga ana e brendshme do të bëhet deponimi i aluvioneve.




Figura 8. Rrjedhja e ujit në lum meandrues (Burimi: B.H)




Figura 9. Parametrat e përshkrimit të meandrës (Burimi: B. H)

2.1.4 Hidraulika e lumenjve

Çdo lum ndryshon nga lumenjtë tjerë në bazë të madhësisë, pjerrtësisë, prurjes, pellgut ujëmbledhës etj. Madhësitë kryesore që i karakterizojnë të gjithë lumenjtë janë:

- **Sforcimi në tërheqje** paraqet forcën për njësi e cila vepron në shtrat të lumit. Kjo varet nga shumë faktorë si gjeometria e lumit, prurja dhe sedimentet. Rëndësia e studimit të sforcimeve në tërheqje qëndron në faktin e qëndrueshmërisë së shtratit nga lëvizja e sedimenteve që janë në fund të lumit.
- **Rezistenca e rrjedhjes** paraqet rezistencën që i bën shtrati i lumit, rrjedhjes së ujit. Sa më rezistent shtrati i lumit, prurja e tij do të jetë më e vogël. Rezistenca varet nga lloji i materialit të shtratit të lumit. Në vijim kemi të paraqitur një tabelë me koeficientët e Manning-ut me vlerat e rezistencës për materialet e ndryshme.

Tabela 3. Koeficienti i Manning-ut për materialet e ndryshme (Burimi: B.H)

Lloji i materialit	Koeficienti i Manning-ut (n)
Azbest cimento	0.011
Asfalt	0.016
Kubëza nga betoni	0.011
Tulla nga argjila	0.014
Bakër	0.011
Beton i armuar i lëmuar	0.011
Beton i paarmuar	0.012
Tokë e lëmuar	0.018
Kanal i pastër natyror	0.022
Kanal zhavorrik	0.025
Kanal natyror me barishte	0.03
Hekur i galvanizuar	0.016
Metal i korroduar	0.022
Plastikë	0.009
Çelik	0.012
Druri i lameluar	0.012
Druri i palameluar	0.014
Xhami	0.010

- **Rrjedhja në kanale të hapura** paraqet lëvizjen e ujit në kanale të hapura me sipërfaqe të lirë ku vepron presioni atmosferik.

Rrjedhje në kanale të hapura konsiderohen rrjedhjet e lumenjve, përrockave, kanaleve të ujitjes etj.




Figura 10. Paraqitja grafike e rrjedhjes në kanale të hapura (Burimi: B.H)

Prurja në kanale të hapura llogaritet nga shprehjet e mëposhtme

Shpejtësia nëpër gypa sipas Sheziut është: $v = c * \sqrt{R * i}$

$c = \frac{1}{n} * R^{1/6}$ sipas Manning-ut

Nga kjo rrjedh shprehja: $v = \frac{1}{n} * R^{2/3} * \sqrt{i}$

Atëherë prurja do të jetë: $Q = \frac{1}{n} * R^{2/3} * \sqrt{i}$

R - Rrezja hidraulike $R = \frac{A}{P}$ (m)

A - Sipërfaqja e lagur (m^2)

P - Perimetri i lagur (m)




Figura 11. Prerja tërthore e një kanali të hapur (Burimi: B.H)

Në vijim kemi të paraqitur llojet e ndryshme të kanaleve të hapura dhe elementet gjeometrike të tyre.

Lloji i kanalit	Sipërfaqja A	Perimetri i lagur	Rrezja hidraulike
Drejtëkëndësh	by	$b + 2y$	$\frac{by}{b + 2y}$
Trapez	$(b + my)y$	$b + 2y\sqrt{1 + m^2}$	$\frac{(b + my)y}{b + 2y\sqrt{1 + m^2}}$
Trekëndësh	my^2	$2y\sqrt{1 + m^2}$	$\frac{my}{2\sqrt{1 + m^2}}$
Rreth	$\frac{1}{8}(2\theta - \sin 2\theta)d_0^2$ $\theta = \pi - \arccos$ $\left[\left(y - \frac{d_0}{2}\right)/(d_0/2)\right]$	θd_0	$\frac{1}{4}\left(1 - \frac{\sin 2\theta}{2\theta}\right)d_0$

Figura 12. Prerjet tërthore të kanaleve të hapura dhe elementet gjeometrike të tyre (Burimi: B. H)

Energjia specifike e rrjedhjes në kanale të hapura shprehet me formulën:

$$H = z + y + \frac{v^2}{2g}$$

Energjia specifike në një profil tërthor jepet me formulën:

$$E = y + \frac{v^2}{2g}$$

ku y paraqet thellësinë kritike të profilin tërthor

Koncepti i energjisë specifike u prezantua fillimisht nga Bakmeteff dhe paraqet energjinë e ujit në një profil tërthor. Kjo energji varet nga thellësia e ujit.




Figura 13. Energjia specifike (Burimi: B. H)

Thellësia normale në një kanal të hapur paraqet thellësinë e ujit për rastin kur pjerrtësia e ujit është e njëjtë me pjerrtësinë e fundit të kanalit.




Figura 14. Thellësia normale e rrjedhjes (Burimi: B.H)

Thellësia kritike paraqet thellësinë minimale për të cilën rrjedhja mund të vetshkarkohet.

Kjo thellësi më së lehti përcaktohet nga numri i Fraude-it.

Numri i Fraude-it jepet me shprehjen:

$$Fr = \sqrt{\frac{v^2}{g * h_{kr}}} = \sqrt{\frac{\text{forca inerciale}}{\text{pesha}}}$$

Për ta gjetur thellësinë kritike të çfarëdo prerje tërthore të kanaleve të hapura, e barazojmë numrin e Fraude-it me 1, pra $Fr = 1$.

Kemi tri lloje të rrjedhjeve në kanale të hapura dhe ato janë:

1. **Rrjedhja superkritike (e rrëmbyeshme)** e cila paraqet rrjedhjen që karakterizohet me shpejtësi të madhe dhe thellësi kritike të vogël. Rrjedhja superkritike konsiderohet ajo rrjedhje që ka numrin e Fraude-it $Fr > 1$;
2. **Rrjedhja kritike (normale)** paraqet rrjedhjen që karakterizohet me shpejtësi dhe thellësi kritike mesatare. Rrjedhje normale konsiderohet ajo rrjedhje që ka numrin e Fraude-it $Fr = 1$;
3. **Rrjedhja subkritike (e qetë)** paraqet rrjedhjen që karakterizohet me shpejtësi të vogël dhe thellësi kritike të madhe. Rrjedhja subkritike konsiderohet ajo rrjedhje që ka numrin e Fraude-it $Fr < 1$.

2.1.5 Sedimentet

Disa lumenjë, sidomos të vegjlit që rrjedhin në viset malore, rrjedhin direkt nëpër shkëmbinj. Këta lumenjë quhen lumenjë shkëmbor apo joaluvial.

Lumenjtë tjerë që rrjedhin nëpër terrene fushore apo terrene ku mund të bartin sediment, quhen lumenjë aluvial. Ka lumenjë që kanë dy format përgjatë gjatësisë së tyre.




Figura 15. Format e shtratit të lumit në varësi të terrenit (Burimi: B. H)

Sedimentet paraqesin grimca të cilat transportohen përgjatë shtratit të lumit si pasojë e erozionit që bën uji përgjatë shtratit.

Sasia më e madhe e tij paraqitet pas periudhave të gjata me thatësi. Sa më e gjatë periudha me reshje, aq më e vogël është sasia e sedimenteve.

Kur forca në tërheqje e shtratit të lumit T_0 , tejkalohet nga forca e ujit, fillon lëvizja e sedimenteve, kështu duke formuar një sforcim tjetër tërheqës T_{0c} .

Transporti i sedimenteve bëhet përmes rrëshqitjes, rrotullimit dhe kërcimit.

Sedimentet ndahen në tri grupe:

- Sedimentet në fund të shtratit të lumit, quhen ngarkesë kontaktuese.
- Sedimentet që lëvizin për një kohë të shkurtër lart dhe prapë pas një distance bien në fund, njihen si ngarkesë kërcyese.
- Sedimentet që gjenden në suspension quhen ngarkesë në suspension.




Figura 16. Gjendja e ndryshme e sedimenteve (Burimi: B. H)

2.2 Reshjet

Reshjet paraqesin çdo formë të ujit, të lëngët apo të ngurta, që bie nga atmosfera dhe arrin në tokë. Ato janë një komponent kyç i ciklit të ujit të Tokës, ku uji avullon nga oqeanet, liqenet dhe lumenjtë e tjerë, ngrihet në atmosferë, formon re dhe pastaj kondensohet në pikëza ose kristale akulli që në fund bie përsëri në sipërfaqen e Tokës.

Reshjet mund të kenë forma të ndryshme, të paraqitura si në vijim:

Shiu: Pikëza ujore të lëngëta që bie nga reja kur kushtet atmosferike janë relativisht të ngrohta.

Dëbora: Kristalet akulli që formohen në re dhe bie në tokë kur temperaturat janë të ftohta aq sa duhet. Hërëza të akullit kanë forma të ndërlikuara dhe unike.

Skllotë: Borë e përzier me shi, etj.

Reshjet luajnë një rol të rëndësishëm në formimin e klimës së Tokës, modelet e motit dhe ekosistemeve. Ato ndihmojnë në shpërndarjen e ujit në të gjithë planetin, plotësojnë burimet e ujit të ëmbël si lumenjtë, liqenet dhe rezervuarët e ujit nën tokë. Rajone të ndryshme përjetojnë sasira dhe lloje të ndryshme të reshjeve bazuar në faktorë si gjeografia, klima dhe ndryshimet sezonale. Në Kosovë paraqiten të gjitha format e reshjeve atmosferike. Rëndësinë më të madhe e kanë reshjet në formë të shiut nëpër lugina dhe reshjet e borës në viset e larta malore (Bjeshkët e Nemuna dhe Sharr), ku në pjesën lindore të Kosovës, mesatarisht gjatë vitit bien mbi (600 mm) ndërsa në pjesën perëndimore mbi (700 mm). Gjatë vitit sasia më e madhe e reshjeve bie në Bjeshkët e Nemuna (1750 mm). Reshjet e borës janë dukuri e rëndomtë në pjesën e ftohtë të vitit. Në pjesët e ulëta të Kosovës mesatarisht paraqiten 26 ditë me reshje bore, kurse në viset malore mbi 100 ditë.

Stacioni i parë për matjen e të reshurave në territorin e Kosovës ka filluar me vërtetime në vitin 1925. Pas luftës me themelimin e institucioneve shtetërore është themeluar edhe Instituti Hidrometrologjik i Kosovës i cili bënë regjistrimin e reshjeve përmes stacioneve vërtetuese të vendosura në disa lokalitete të Kosovës.

Rrjeti ekzistues i stacioneve të reshjeve atmosferike përbëhet nga 13 shimatës automatik dhe 53 manual. Në bazë të të dhënave të regjistruara në stacionet matëse, mesatarja vjetore e të reshurave në Kosovë ndryshon prej 570 mm (Dardanë) deri 1408 mm (Junik).

2.2.1 Cikli hidrologjik

Cikli hidrologjik është një proces natyror i ndjekur nga uji si pasojë e evaporimit, kondensimit, ndotjes, filtrimit dhe rrjedhjes së ujit nëpër shumë faza dhe mjedise të ndryshme. Ky cikël përshkruan lëvizjen e ujit nëpër tokë dhe atmosferë. Cikli hidrologjik është një komponent thelbësor i sistemit tokësor dhe një pjesë e rëndësishme e klimës globale.

Rreth $\frac{3}{4}$ e sipërfaqes së tokës është e mbuluar me ujë dhe si pasojë e kësaj, bëhet avullimi i ujit nga lumenjtë, liqenet, detet, oqeanet, nga sipërfaqet me vegjetacion etj.

Ky avullim shkon në atmosferë, ku bëhet kondensimi i tij dhe bie në formë të shiut, borës apo breshërit. Një pjesë e reshjeve infiltron në tokë dhe pjesa tjetër rrjedh deri në përrocka, lumenjë, liqene, dete apo oqeanet.

Ky cikël përsëritet vazhdimisht gjatë gjithë kohës.

$$P_{mes}(mm) = \frac{\sum P_i}{n} = \frac{\text{shuma e reshjeve të stacioneve përkatëse}}{\text{numri i stacioneve}}$$

- **Metoda e Thiessen-it:** Është metodë më e saktë se metoda e mesatares aritmetike. Përdoret për llogaritjen e reshjeve për stacionet e shpërndara në mënyrë jouniforme. Stacionet kanë pozicione të caktuara dhe janë të lidhur në mes vete me vija të drejta. Pastaj në mes të atyre vijave, vendosen vijat tjera në kënd 90° , kështu duke formuar poligonet e Thiessen-it. Llogaritja e reshjeve bëhet me shprehjen:

$$P_{mes}(mm) = \frac{\sum P_i * A_i}{\sum A_i}$$

Ku, A = Sipërfaqja (km^2)

P_{mes} = Reshjet mesatare (mm) dhe P_i = Reshjet në stacionet përkatëse (mm)




Figura 18. Metoda e Thiessen-it (Burimi: B. H)

- **Metoda e izohjeteve:** Nga tri metodat e përmendura, kjo është me saktë. Kjo metodë përdoret për llogaritjen e reshjeve mesatare për stacionet e shpërndara në mënyrë jouniforme. Stacionet janë të vendosura në pellg dhe lidhen me vija pikat me lartësi të njëjtë të reshjeve duke formuar izohjetet. Sipërfaqja në mes të dy izohjeteve të njëpasnjëshme paraqet sipërfaqen që llogaritet për reshjet mesatare.

Reshjet me këtë metodë llogariten me shprehjen:

$$P_{mes}(mm) = \frac{\sum A_{1-2} * P_{1-2}}{\sum A_{1-2}}$$




Figura 19. Metoda e izohjeteve (Burimi: B. H)

2.2.4 Matja e reshjeve

Instrumentet për matjen e reshjeve janë ndahen në dy kategori kryesore, të cilat janë:

- Instrumentet manuale;
- Instrumentet automatike

Instrumentet manuale

Si më i zakonshëm është instrumenti i Simons-it. Përbëhet nga një hinkë me diametër 12.7 cm në pjesën e jashtme. Pjesa e jashtme e hinkës është në lartësi 35 cm nga niveli i terrenit.

Uji që futet në hinkë, mbliidhet në një enë metalike me përshkallëzim ku lexohet lartësia e reshjeve.




Figura 20. Instrumenti i Simons-it (Burimi: B.H)

Instrumentet automatike

Janë më të mira për përdorim se ato manualet, sepse jo vetëm që matin sasinë e reshjeve, por mesin edhe kohëzgjatjen e reshjeve, intensitetin dhe kohën në mes të dy apo më shumë reshjeve.




Figura 21. Regjistruesi automatik i reshjeve (Burimi: B.H)

Ne Skënderaj, kemi matje historike prej viteve 1948-1978, si në vijim:




Figura 22. Vlerat mesatare historike të reshjeve (Burimi: http://www.ammk-rks.net/repository/docs/Resurset_ujore_te_Kosoves.pdf)

2.3 Matjet hidrometrike

Matja e rrjedhjes së lumit është procesi i përcaktimit të vëllimit të ujit që lëviz nëpër një lumë ose lumenj gjatë një periudhe të caktuar kohore. Matja e saktë e rrjedhjes së lumit është e rëndësishme për qëllime të ndryshme, përfshirë menaxhimin e burimeve të ujit, parashikimin e përmytjeve, prodhimin e energjisë hidroelektrike, monitorimin ambiental dhe hulumtimin shkencor.

Dega e cila merret me matjen e sasisë së ujit gjatë gjithë kohës quhet hidrometri.

Ka disa metoda të përdorura për të matur rrjedhjen e lumit:

Matjet hidrometrike ndahen në dy kategori kryesore të matjeve:

1. Matjet direkte;
2. Matjet indirekte.

Në matje direkte, përfshihen katër metoda kryesore, të cilat janë:

- a) Metoda e sipërfaqeve - shpejtësive;
- b) Metoda me hollim;
- c) Metoda elektromagnetike dhe
- d) Metoda ultrasonike.

Në matje indirekte, përfshihen dy metoda kryesore, të cilat janë:

- a) Matjet përmes pendave, kapërderdhësive të ndryshëm dhe portave;
- b) Metoda pjerrtësi – sipërfaqe.

Në përgjithësi, matjet e vazhdueshme hidrometrike të lumenjve janë të pamundshme si pasojë e kostonë së lartë, kohës dhe kushteve atmosferike. Prandaj, përdoret procedura me dy hapa si në vijim:

1. Prurja në një lum, përcaktohet nga lartësia e nivelit të ujit përmes matjeve dhe
2. Vëzhgimi dhe matja e prurjes së ujit, përmes lakoreve prurje – kohëzgjatje.

Metoda e dytë është pak e kushtueshme dhe prandaj përdoret nga të gjithë.

2.3.1 Vendmatjet hidrometrike

Vendmatjet hidrometrike janë stacione të përhershme ose të përkohshme të pajisura me instrumente për të monitoruar në mënyrë të vazhdueshme nivelin e ujit në lumenj, dete dhe burime të tjera të ujit. Këto stacione ofrojnë të dhëna të rëndësishme për gjendjen hidrometeorologjike dhe rrjedhjen e ujit, të cilat janë të domosdoshme për menaxhimin e burimeve të ujit, parashikimin e përmytjeve, monitorimin e cilësisë së ujit, dhe hulumtimin shkencor.

Vendosja e vendmatjeve hidrometrike, bëhet duke pasur parasysh që;

- Prurja e ujit të jetë sa më e njëtrajtshme, si shkak i profilit tërthor, natyrës së terrenit, madhësisë së shpejtësisë së rrjedhjes, etj;
- Çasshmëria dhe Siguria: Vendmatjet duhet të jenë të lehtësisht të çasshme për të bërë instalimin, mirëmbajtjen, dhe mbledhjen e të dhënave. Siguria e personelit dhe pajisjeve është gjithashtu një kriter i rëndësishëm;
- Shtrati të ketë një formë sa më të rregullt, pa degëzime dhe pa bimësi në fund;
- Në një gjatësi minimale, sa dyfishi i gjerësisë sipër dhe poshtë vendmatjes hidrometrike, rrjedhja e ujit të jetë sa më e qetë;
- Vlerësimi i rrezikut: Rreziku i përmbytjeve, përplasjeve dhe dëmtimit të stacioneve nga faktorë të ndryshëm (p.sh. akullnajat, dëmtime natyrore) duhet të merret në konsideratë gjatë pozicionimit;
- Shtrati i lumit të jetë sa më i qëndrueshëm (të mos ketë erozion dhe depozitim të sedimenteve);
- Vendi i hidrometrave të jetë sa më larg ndikimit që mund të bëhet nga faktorët e ndryshëm siç janë njerëzit apo objektet e ndryshme.

2.3.2 Instrumentet matëse

Kemi shumë lloje të ndryshme të instrumenteve që matin prurjet apo shpejtësitë për lumenjë.

Në vijim kemi të paraqitur disa më kryesorët që përdoren.

Instrumentet manuale

- Lata: Është instrumenti më i thjeshtë për matjen e nivelit të ujit. Paraqet një shkop me shkallëzim dhe përcaktimi i nivelit të ujit bëhet kur niveli i ujit prek në përshkallëzim dhe kështu përcaktohet lartësia e ujit. Përshkallëzimi mund të lexohet mirë edhe nga një distancë e afërt. Latat mund të vendosen drejtë vertikalisht apo pjerrët. Ato mund të vendosen edhe në objekte të ndryshme, mjafton që të mund të bëhet leximi i nivelit. Ndonjëherë si pasojë e terrenit të papërshtatshëm nuk mund të lexohet niveli vetëm nga një latë dhe kështu vendosen dy apo më shumë lata.




Figura 23. Matjet hidrometrike me latë (Burimi: B.H)

- Instrumenti me tel: Përdoret për matjen e nivelit të ujit për lumenjë apo liqene ku nuk mund të matet me latë si pasojë e thellësisë së madhe. Zakonisht matja bëhet nga ura, ndonjë strukturë tjetër apo edhe nga anijet. Një peshë lëshohet për ta prekur sipërfaqen e lirë të ujit. Një disk mekanik llogaritet rrotullimin e rrotës e cila është proporcionale me gjatësinë e telit jashtë. Gjatësia maksimale operuese për këtë instrument është 25 m.

Instrumentet automatike

Edhe pse instrumentet manuale të matjes janë më të lira për operim, ato duhet të lexohen manualisht me saktësi përgjatë kohës. Instrumentet automatike i tejkalojnë këto mangësi dhe bëjnë regjistrimin e të dhënave në mënyrë automatike të cilat i dërgojnë deri te përdoruesi.

Si instrumentet më të përdorura automatike janë:

- Regjistruesi notues;
- Instrumenti fluskues.

2.3.3 Matja e shpejtësisë

Përmes përcaktimit të shpejtësisë së rrjedhjes së lumit, mund të llogaritet prurja e tij, duke marrë parasysh edhe sipërfaqen e prerjes tërthore të lumit.

Për të përcaktuar shpejtësinë e rrjedhjes së ujit, ekzistojnë:

- Matja e shpejtësisë përmes notimit të gjësendeve;
- Metoda e matjes së shpejtësisë përmes thellësisë;

- Metoda e sipërfaqeve - shpejtësive;
- Matja e shpejtësisë përmes instrumenteve.

Përcaktimi i shpejtësisë sipas mjeteve notuese

Është një ndër metodat e para e cila është mjaft e thjeshtë dhe praktike e cila bazohet në lëshimin në ujë të mjeteve që kanë peshë më të vogël sesa uji të cilat notojnë.

Për ta përcaktuar shpejtësinë e rrjedhjes së ujit, lëshojmë një objekt në një pikë të caktuar dhe masim kohën e arritjes së objektit në pikën tjetër dhe përmes formulës së shpejtësisë, caktojmë atë:

$$v = \frac{s}{t} = \frac{\text{rruga}}{\text{koha}} \left(\frac{\text{m}}{\text{s}} \right)$$

Metoda e matjes së shpejtësisë përmes thellësisë

Në thellësi më të vogla se 3 m, shpejtësia matet në 0.6 h të thellësisë së lumit.

Kjo procedurë njihet si metoda e një pike.

Në thellësi më të mëdha mund të merren dy apo më shumë pika në thellësi të ndryshme.

Për dy pika, thellësitë e matjes janë në thellësi 0.2 h dhe 0.8 h.

Shpejtësia mesatare përcaktohet me shprehjen: $v = \frac{0.2 h + 0.8 h}{2}$

Për lumenj me rrjedhje të rrëmbyeshme, shpejtësia llogaritet në thellësi 0.5 m nën nivel të sipërfaqes së lirë të ujit dhe shpejtësia mesatare llogaritet përmes faktorit të reduktimit si në vijim:

$v_{\text{mes}} = K \cdot v$, ku vlera e K sillet prej 0.85 deri në 0.95.




Figura 24. Shpërndarja e shpejtësisë sipas thellësisë (Burimi: B.H)

Metoda e sipërfaqeve - shpejtësive

Përmes kësaj metode, llogaritet prurja duke e bërë ndarjen e profilit tërthor, në disa sipërfaqe dhe për shpejtësitë e llogaritura me instrumente, përcaktohet prurja mesatare.

Vendi ku do të matet duhet të plotësojë kushtin që prurja sipas kohës të jetë konstante për një kohë të caktuar disa vjeçare. Si rezultat, disa kushte duhet plotësuar:

- Profili tërthor ku bëhet matja të mos ndryshojë përgjatë stinëve të vitit;
- Profili tërthor duhet të jetë i çashëm gjatë gjithë kohës;
- Vendmatja duhet të jetë e pavarur nga efekti i kanalit etj.




Figura 25. Metoda e sipërfaqeve – shpejtësive (Burimi: B.H)

Atëherë, prurja llogaritet me shprehjen:

$$Q = \sum_i^n \Delta Q_i$$

ΔQ_i – Prurja për një sipërfaqe (m^3/s)

ΔA_i – Sipërfaqja (m^2)

Sipërfaqja e parë dhe e fundit llogariten si trekëndësha, ndërsa sipërfaqet tjera si trapeza.

Matja e shpejtësisë përmes instrumenteve

Është metoda më e përhapur për llogaritjen e shpejtësisë në profile të ndryshme të lumit.

Përbëhet nga një element rrotullues i cili rrotullohet si pasojë e shpejtësisë së ujit në mënyrë këndore, proporcional me shpejtësinë e rrjedhjes.

Ekzistojnë dy lloje kryesore të këtyre matësve:

1. Matësi me aks vertikal
2. Matësi me aks horizontal

Matësi me aks vertikal: Përbëhet nga kupat e vendosura rreth aksit vertikal.

Kupat rrotullohen në rrafsh horizontal dhe një mekanizëm i kompjuterizuar i ngjitur në bosht vertikal regjistron rrotullimet e bashkësisë së kupave. Kufiri i matjes së shpejtësive për këta matës silet prej 0.15 m/s deri në 4 m/s. Saktësia e këtyre instrumenteve është rreth 1.50% për shpejtësi të vogla afër pragut minimal dhe përmirësohet deri në 0.30% për shpejtësi më të mëdha se 1.0 m/s.




Figura 26. Matësi me aks vertikal (Burimi: B.H)

Matësi me aks horizontal: Këta matës kanë një helikë në fund të boshtit horizontal.

Këto instrumente vinë në madhësi të ndryshme të helikave duke filluar prej (6 – 12) cm dhe matin shpejtësi prej 0.15 m/s deri në 4 m/s. Saktësia e tyre është 1% për shpejtësi afër minimale dhe 0.25% për shpejtësi mbi 0.3 m/s.

Ky instrument është i projektuar ashtu që rrotullimi i helikës të jetë proporcional me shpejtësinë e rrjedhjes v . Shprehja matematikore që bën ndërlidhjen në mes të këtyre dy madhësive është:

$$v = a * N + b \text{ ku,}$$

v – Shpejtësia e rrjedhjes (m/s)

N – Numri i rrotullimeve

a dhe b konstante që varen nga lloji i instrumentit.

Vlerat e a dhe b për helikën 12.5 cm janë $a=0.65$ dhe $b=0.03$




Figura 27. Matësi me aks horizontal (Burimi: B.H)

2.4 Vërshimet

Me vërshime nënkuptojmë rrjedhjet e ujit që paraqiten nga lumenjtë, liqenet apo detet në zona të ndryshme tokësore duke shkaktuar vdekje të popullatës dhe dëme materiale.

Ekzistojnë disa lloje të vërshimeve siç mund të jenë:

- **Vërshimet nga lumenjtë:** Ndodhin si pasojë e reshjeve të mëdha të shiut apo edhe të shkrirjes së borës, si pasojë e mos mirëmbajtjes së tyre apo edhe të shtratit tërthor të vogël me ç'rast të paraqitjes së ujërave maksimale, uji del nga shtrati i lumit.




Figura 28. Nivelet e ujit në lum dhe vërshimet nga ujërat e mëdha (Burimi B.H)

- **Vërshimet e shpejta (Flash vërshimet):** Ndodhin si pasojë e shirave të mëdha në pjesët kodrinoro-malore, ku terreni është i pjerrët dhe lumenjtë kanë rënie gjatësore të madhe,

prandaj shpejtësia e vërshimeve është shumë e madhe dhe në rast të këtyre vërshimeve në zonat me dendësi të lartë të popullsisë, këto janë vdekjeprurëse.

- **Vërshimet nga deti:** Paraqiten si pasojë e cikloneve të ndryshme apo edhe të cunameve që mund të ndodhin në det, prandaj nuk rekomandohet të bëhen ndërtime afër bregdetit.
- **Vërshimet urbane:** Ndodhin si pasojë e infrastrukturës së dobët të drenazhimit të qytetit, ku shiu që bie tejkalon aftësinë pranuese të rrjetit të kanalizimit atmosferik.




Figura 29. Ndikimi i urbanizimit në ciklin hidrologjik (Burimi: B.H)

- **Vërshimet nga penda:** Shkaktohen si pasojë e tejkalimit të kapacitetit maksimal të vëllimit të ujit në rezervuar, nga prishja e trupit të pendës, nga tërmetet, nga zvogëlimi i vëllimit të rezervuarit si pasojë e grumbullimit të sedimenteve apo edhe nga akulli.




Figura 30. Vërshimet nga pëndat (Burimi: B. H)

Shkaktarët e vërshimeve dhe humbjet ekonomike

Shkaqet kryesore të vërshimeve janë:

- Reshjet e mëdha
- Urbanizimi dhe rritja e sipërfaqeve të papërshkueshme nga uji;
- Ndërtimet e pakontrolluara në hapësirat përgjatë lumenjve – tokat bujqësore;
- Infrastruktura e dobër drenazhuese;
- Rritja e nivelit të lumenjve;
- Shpyllëzimi dhe zvogëlimi i sipërfaqeve gjelbëruese;
- Ndryshimet klimatike;
- Hudhja e mbeturinave të ngurta në lumenjë etj.

Çdo vit, vdesin me mijëra njerëz si pasojë e vërshimeve në shtratin e lumenjve, ndërsa dëmet materiale janë shumë të mëdha dhe nuk mund të llogariten saktë.

Çdo ditë bëhen modele të ndryshme të sjelljes së ujërave të mëdha dhe mbrojtjes nga to. Zakonisht kjo kryhet përmes të dhënave që mblidhen dhe analizohen përmes GIS-it.

Në vijim është paraqitur një fotografi e vërshimeve në komunë të Skënderajit



Figura 31. Vërshimet në komunën e Skënderajit (Burimi: <https://th.bing.com/th/id/OIP.7Yb0rpYvBtKvKc3NxcOHwAHaE8?pid=ImgDet&rs=1>)

2.4.1 Masat për mbrojtje nga vërshimet

Mbrojtja kundër përmbytjeve nga lumenjtë përfshin një kombinim masash strukturore, planifikim të përdorimit të tokës, sisteme të paralajmërimit të hershëm dhe angazhimin e komunitetit. Këtu janë disa strategji për të ndihmuar në mbrojtjen kundër përmbytjeve nga lumenjtë:

Zonimi i fushës së përmbytjeve dhe planifikimi i përdorimit të tokës:

- Identifikimi i zonave me rrezik përmbytjesh;
- Zbatimi i rregulloreve të zonimit për të parandaluar ndërtimin në zonat me rrezik të lartë përmbytjesh duke promovuar përdorimin e duhur të tokës.

Struktura me lartësi të rritur:

- Ndërtimi i ndërtesave, rrugëve dhe infrastrukturës mbi nivellet e parashikuara të përmbytjes.
- Ngritja e shtëpive mbi nivelin e tokës për të parandaluar hyrjen e ujit në hapësirat e banuara.

Barriera të përmbytjeve:

- Ndërtimi i barriereve të përmbytjeve, mureve të ndërtesave dhe urave të lumenjve për të parandaluar shfrytëzimin e ujit në hapësira të banuara.
- Inspektimi dhe mirëmbajtja e rregullt për këto struktura për të siguruar efektshmërinë e tyre.

Modifikimet e kanaleve:

- Ndryshimi i kanaleve të lumit për të rritur kapacitetin e tyre dhe për të përmirësuar lëvizjen e ujit.
- Krijimi i rrugëve të përmytjes për të devijuar ujin e tepërt larg zonave të banuara.

Menaxhimi natyral i përmytjeve:

- Zbatoimi i zgjidhjeve të infrastrukturës së gjelbër si rikthimi i vendeve të lagura, mbjellja e bimëve dhe krijimi i sipërfaqeve të përshtatshme për të përthithur ujin e shiut dhe për të ngadalësuar fluksin e ujit.

Sistemet paralajmëruese të hershme:

- Zhvillimi dhe zbatimi i sistemeve të efektshme të paralajmërimit të hershëm për të dhënë alarma kohët e fundit për banorët dhe autoritetet në lidhje me përmytjet e ardhshme.
- Kombinimi i të dhënave meteorologjike, monitorimi i lumenjve dhe komunikimi me komunitetin.

Arsim dhe Përgatitja e Komunitetit:

- Edukimi i banorëve për rreziqet e përmytjeve, rrugët e evakuimit dhe procedurat e emergjencave.
- Zhvillimi i ushtrimeve dhe trajnimeve për të siguruar që komuniteti të jetë i përgatitur për ngjarjet e përmytjeve.

Sigurimi i përmytjeve:

- Inkurajimi i banorëve në zonat me rrezik përmytjesh të kenë mbulim sigurimi përmytjesh.
- Sigurimi mund të sigurojë ndihmë financiare për rimëkëmbjen dhe rindërtimin pas ngjarjeve të përmytjeve.

Restaurimi i lumenjve:

- Rikthimi dhe përmirësimi i tipareve natyrale të lumit, si vijat dhe fushat e përmytjes, për të përmirësuar fluksin e ujit dhe zvogëlimin e rrezikut nga përmytjet.

Bashkëpunimi Ndërkombëtar:

- Bashkëpunimi me vendet fqinje në menaxhimin e lumit të kalimtarëve për të adresuar ndikimin e përmytjeve nga montimi dhe zbritja.

2.4.2 Analiza e frekuencës hidrologjike

Qëllimi i analizës së frekuencës hidrologjike është ndërlidhja e madhësisë së ngjarjeve extreme me frekuencën e ndodhjes duke shfrytëzuar metodat e probabilitetit të shpërndarjes.

Në praktikë, probabiliteti i shpërndarjes së ngjarjeve për një regjion është i panjohur.

Analiza e frekuencës së vërshimeve, zakonisht bëhet për këto qëllime:

1. Vlerësimin e kapacitetit të strukturave të ndryshme infrastrukturore;
2. Përcaktimi i metodave mbrojtëse nga vërshimet;

Ndodhja e secilës ngjarje ekstreme, llogaritet me njërën nga këto formula:

$$T = \frac{N}{M}$$

$$T = \frac{N}{M - 0.5}$$

$$T = \frac{N - 1}{M}$$

Ku

N = numri i viteve të shënuara

M = numri i renditjes së ngjarjeve

T = periudha e përsëritjes së ngjarjes

Shprehja e përgjithshme për frekuencën e analizës së vërshimeve sipas Chow është:

$$X_T = X_{mes} + k * \sigma$$

Ku

X_T = prurja për periudhën kthyesë T vjeçare

X_{mes} = mesatarja aritmetike e prurjeve (m^3/s)

σ = devijimi standard (m^3/s)

K = koeficient në funksion të T viteve

2.4.3 Vlerësimi i rrezikut nga vërshimet

Me qëllim të mbrojtjes ndaj vërshimeve, pendat, urat dhe kanalet e hapura, projektohen duke u bazuar në një periudhë kthyesë të prurjeve ekstreme. Periudha kthyesë ndryshon, varësisht nga rëndësia e objektit. Te lumenjtë, periudha kthyesë merret 25-50 vite.

Periudha kthyesë paraqet kohën, në të cilën ekziston mundësia të paraqitet prurja tjetër me të njëjtën magnitudë.

Ky koncept, tregon se ekziston një lidhje në mes të periudhës kthyese dhe frekuencës (probabilitetit) si në vijim:

$$P = \frac{1}{T}$$

P – Probabiliteti teorik i ndodhjes së ngjarjes për T-vite

T – Periudha kthyese

Ndërsa probabiliteti i mosndodhjes është:

$$S = 1 - P = 1 - \frac{1}{T}$$

Gjatë n-viteve, duke parë që ngjarjet ekstreme janë të pavarura nga njëra tjetra, probabiliteti i ndodhjes së ngjarjes ekstreme, për n-vite, për projektim të objekteve, llogaritet me shprehjen:

$$P_n = \left(1 - \frac{1}{T}\right)^n$$

n – paraqet numrin e viteve

Njëkohësisht probabiliteti i mosndodhjes do të jetë:

$$S_n = 1 - P_n = 1 - \left(1 - \frac{1}{T}\right)^n$$

2.5 Pozita gjeografike e Skënderajit

Komuna e Skënderajit zë vend qendror në Drenicë, shtrihet në një sipërfaqe prej 378 km². Në veri kufizohet me Komunën e Mitrovicës, në lindje me Vushtrrin, në jugëperëndim me Drenasin (Gllogovcin) dhe Klinën, ndërsa në përendim me Burimin (Istogun). Nëpër Komunë kalojnë rrugë të rëndësishme automobilistike të cilat e lidhin me qendrat e tjera të Kosovës.

Territori i Komunës së Skënderajit ka konfiguracion kodrinoro-malorë me lartësi mbidetare mesatare prej 500-700m, kurse pikën më të lartë e paraqet maja e Qyqavicës me lartësi 1 117 m. Ka relief të butë, përshkohet me lugina lumenjësh të vegjël, kryesisht dominon klimë e mesme kontinentale që karakterizohet me dimëra të ashpër, vera të thata me temperatura të larta e reshje të pakta, ndërsa ka një florë dhe faunë të pasur.

Në Komunën e Skënderajit banojnë mbi 72 mijë banorë ku 99% janë shqiptarë. Në strukturën e popullsisë kryesisht dominon moshë e re dhe atë: 47 % deri në moshën 20 vjeçare, 48 % nga 20-60 vjeçë, ndërsa vetëm 5 % të moshuar mbi 60 vjeçë. Shtimi natyrorë ka një shkallë të lartë, mbi 28 promila me një shkallë të ulët të vdekshmërisë rreth 5 promila.

Komuna e Skënderajit si pozicion gjeografik, gjendet në qendër të Kosovës, 50 km në veriperëndim të Kosovës.

Skënderaji si komunë është i përfshirë në regjionin e Mitrovicës dhe është 20 km në juglindje të këtij qyteti.

Komuna e Skenderajit është në qendër të Kosovës dhe kufizohet me këto komuna të Kosovës:

- Në Veri me Mitrovicën
- Në Veriperëndim me Burimin (Istogun)
- Në Perëndim me Klinën
- Në Juglindje me Drenasin
- Dhe në Verilindje me Vushtrrinë

Nëpër Komunë kalojnë disa rrugë me karakter të rrugëve nacionale si:

- Në pjesën veriore rruga Pejë- Mitrovicë, e cila ka akse Lindje – Perëndim.
- Rruga Skënderaj- Drenas-Komoran -Prishtinë, ka aks Veri-Jug dhe është rrugë me karakter nacional
- Me karakter të rrugës regjionale është rruga Skënderaj – Klinë.
- Gjithashtu Skënderaji është i lidhur edhe me një rrugë të kategorisë së IV me qytetin e Vushtrrisë.

Karakteristikat gjeologjike

Sipas shënimeve të mëherëshme që janë shfrytëzuar për plane Urbanistike dhe të shënimeve tjera hulumtuese, toka e Komunës nga aspekti gjeologjik është e ndryshueshme ku mbizotrojnë argjilet laporike me thëngjill, me rërë dhe zhavor-pont, dhe në disa vendbanime toka është gëlqerore dhe humusore.

Karakteristikat Morfologjike

Komuna e Skënderajt gjendet në zonën ku lartësia mbidetare sillet prej 500 dhe 700 m. Me këtë lartësi ajo gjërisht është e hapur nga jugu në drejtim të Drenasit dhe Fushës së Drenicës, me një hyrje në verilindje kah Mitrovica dhe në jugperëndim kah Klina, nga Rrafshi i Dukagjinit.

Në lindje të Skënderajt, ngritet terreni nga malet e Qyqavicës në një lartësi prej 1.091 m, ndërsa në veriperëndim me 1.117 m lartësi dhe me male të thata 1.750 m lartësi.

Në përgjithësi nga aspekti gjeomorfologjik mund të cekim se terreni i Komunës me vendbanime është i përshtatshëm dhe nuk paraqet ndonjë faktor kufizues që do të pengonte shtrirjen e mëtejshme topografike.

Karakteristikat klimatike

Në komunën e Skënderajit si makroklimë mbizotëron klima kontinentale me verëra të nxehta dhe me dimëra shumë të ashpër dhe të ftohtë. Meqënëse komuna ka një terren kodrinor – malor me siguri ka edhe mikroklima të caktuara në pjesë të caktuara të territorit të saj, por në mungesë të një stacioni meteorologjik nuk ka të dhëna të sakta. Të dhënat për kushtet klimatike të komunës merren nga stacioni meteorologjik i Mitrovicës.

- Temperatura mesatare vjetore është 10 shkallë Celzius
- Muaji me i nxehtë është Korriku dhe Gushti me 20.4 °C;
- Muaji me i ftohtë është Janari me – 13.4 °C;
- Maksimumi absolut arrihet në Gusht me mbi 36.4 °C;
- Minimumi absolut arrihet në shkurt -25.24 °C;

Erërat dominante në Skënderaj kanë drejtimin e veriperëndimit. Erërat verore dhe pranverore fryejn nga jugu. Shpejtësitë mesatare më të mëdha të erërave janë:

- Perëndimore 9.3 m/s;
- Verilindore 4.2 m/s;
- Veriperëndimore 3.8 m/s;
- Jugore 2.8 m/s dhe
- Lindore 1.6 m/s.

Në komunë gjatë vitit të reshurat mesatare janë 604,8 mm.

- Vjetorja maksimale 850.9 mm (të reshura)
- Vjetorja minimale 394.9 mm (të reshura)
- Ditët më të hershme 5.11
- Ditët më të vonshme 3.05

Lagështia relative mesatare vjetore e ajrit është 71.4%. Lagështia relative mesatare sipas stinëve në verë është 62.5 %, në pranverë 68.5 %, në vjeshtë 72.6 % dhe në dimër 81.6 %.

Karakteristikat hidrografike

Terreni në të cilin është komuna e Skenderajt i takojnë slivit të Detit Adriatik. Në lindje të komunës rrjedh lumi Klina, rrjedha e majtë e Drinit të Bardhë. Në lindje dhe juglindje rrjedhin lumenjtë Sitnica dhe Drenica.

Lumi “Klina” buron në fshatin Kuqicë dhe përshkon territorin në aksin veri jug dhe kalon nëpër tërë territorin e Komunës si dhe në qendrën e qytetit të Skënderajit me një rrjedhë të ngadalshme, me një thellësi mesatare dhe një gjatesi prej 40 km.

Gjithashtu nëpër territorin e komunës ka edhe një numër të madh përrockash të cilat në tërësi derdhen në lumin “Klina”.

Rrjedhat e lumenjëve nuk i rrezikojnë vendbanimet sepse ato deri më tani nuk kanë dalur nga shtrati i tyre.

Në territorin e Komunës së Skënderajit nuk egziston asnjë liqen, as natyrorë por as edhe artificial përpos disa rezervateve të ujit të cilët edhe ata janë në numër të vogël.

Karakteristikat Sizmike të Komunës

Komuna e Skënderajit bënë pjesë në dy zona sizmike:

- Në zonën me dridhje prej VI shkallë të Rihterit dhe
- Në zonën me dridhje prej VII shkallë të Rihterit

Në zonën prej VI shkallë të Rihterit bënë pjesë 5/6 e sipërfaqes së përgjithshme të Komunës në përgjithësi. kryesisht pjesa përendimore e komunës.

Në zonën prej VII shkallë të Rihterit bënë pjesë 1/6 e sipërfaqes së përgjithshme, kryesisht në pjesën lindore të komunës.

Në zonën prej VII shkallë të Rihterit bënë pjesë 1/6 e sipërfaqes së përgjithshme Në bazë të karakteristikave gjeodezike dhe karakteristikave të zonës sizmike të Skënderajit paraqet një mesatare të dridhjeve sizmike.

Karakteristikat pedologjike

Komuna e Skenderajt shtrihet në terrenin me përbërje të llojllojshme pedologjike. Në bazë të shënimeve nga Plani Urbanistik i vitit 1974 shihet se territori i ngushtë i qendrës së qytetit ka një përbërje ranore, me prezencën e karbonateve, Aluvininë, ndërsa në pjesët tjera të terrenit të

komunës, përbërja e tokës është humusore dhe smonicë. Kualiteti i tokës variron nga toka e klasit të parë deri te toka e klasit të V-stë.

Kategoritë e tokës

Sipas shënimeve katastrale dhe studimeve të mëhershme toka e komunës përfshihet në kategoritë I deri në VI si dhe tokën e pakategorizuar jopjellore (tokë shterrpë) Një pjesë shumë e vogël me afro 10 % të sipërfaqes së gjithmbarshme bënë pjesë në kategorinë e II-të dhe të I-rë, ndërsa pjesa dërmuese bënë pjesë në kategorinë V dhe të VI.

3. Modelimi i lumit Klina

3.1 Informata mbi lumin Klina

Lumi Drini i Bardhë është lumi më i gjatë në Kosovë me një gjatësi rreth $L=110.71$ km, prurje mesatare $Q_{mes}=61.70$ m³/s dhe sipërfaqe të pellgut ujëmbledhës $A= 4340$ km².

Lumenjtë më të mëdhenjë që shkarkohen në Drinin e Bardhë janë Bistrica e Pejës, lumi Klina dhe lumi Mirusha.

Lumi i Klinës buron nga shpatet verilindore të Malit të Thatë (Suva Planina), në jug të liqenit artificial Ujmanit (Gazivodes) në lumin Ibar. Në pjesën fillestare të rrjedhës, lumi Klina ka shumë kthesa, së pari rrjedh në lindje (në fshatin Kaldura), kthehet në jug (në Jabuka), përsëri në lindje (në Crepulja) dhe në juglindje (në Gornji Strmac).

Siç rrjedh paralel me lumin e Ibrit dhe Sitnicës, ai kalon pranë rrënojave mesjetare të qytezës së Perkovacit dhe fshatin Klina e Epërme, duke arritur në qendrën rajonale të Skënderajit, fshatin Laushë dhe manastirin e Deviçit, ku Klina kthehet në jugperëndim, duke shënuar kufirin verior të rajonit të Drenicës (Lumi Klina, 2023).

Lumi Klina karakterizohet me këto veçori:

- Gjatësi $L=72.12$ km;
- Prurje mesatare $Q_{mes}=2.08$ m³/s;
- Prurje specifike $q=4.92$ l/s/km²
- Pjerrtësi mesatare $i=4.50\%$.



Figura 32. Situacioni i lumit Klina (Burimi: B.H)

3.2 Gjendja ekzistuese e lumit Klina

Lumi Klina në segmentin që e kemi marrë për analizë të vërshimit, ka gjerësi të fundit të shtratit (4 dhe 6) m dhe thellësi 2.00 m.

Është shtrat i rregulluar me gurë të mveshur dhe fund natyror të lumit.

Në vijim janë paraqitur dy fotografi, ku paraqitet se si duket lumi Klina, për segmentin që e kam marrë për modelim.



Figura 33. Gjendja ekzistuese e lumit Klina sipas fotografive të shkrepura (Burimi: B.H)

Në bazë të matjeve në terren, kam parë se shtrati i lumit ka dy profile tërthore me dimensione të ndryshme.

Nga stacionazhat S38 deri më S48, shtrati i lumit ka profilin tërthor me dimensione si në vijim:




Figura 34. Profili tërthor për stacionazhat S38-S48 (Burimi: B. H)

Nga stacionazhat S1 deri më S37, shtrati i lumit ka profilin tërthor me dimensione si në vijim:




Figura 35. Profilët tërthorë për stacionazhat S1-S37 (Burimi: B. H)

3.3 Llogaritjet hidrologjike

Pas sigurimit të prurjeve maksimale nga shënimet e matura për periudhën e viteve 1948-1978 për stacionin hidrometrik të lumit Klina në Klinë, të paraqitura në bazën për hidroekonominë e Kosovës, kam bërë përcaktimin e prurjeve maksimale 20, 50 dhe 100 vjeçare për lumin Klina, ku kam arritur në këto rezultate:

- Prurja mesatare: $Q_{mes} = 2.08 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike vegetative: $Q_{mes} = 0.048 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja ekologjike ekstravegetative: $Q_{mes} = 0.032 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja maksimale 20 vjeçare: $Q_{maks}^{20} = 48 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja maksimale 50 vjeçare: $Q_{maks}^{50} = 85 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja maksimale 100 vjeçare: $Q_{maks}^{100} = 110 \text{ m}^3/\text{s}$
- Prurja maksimale 100 vjeçare + faktori klimatik: $Q_{maks}^{100} = 180 \text{ m}^3/\text{s}$

Këto të dhëna do të futen në HEC – RAS, ku do të bëhet modeli i përmbytjeve.

3.4 Modelimi hidraulik i lumit Klina

Modelimi i lumit të Lumit të Klinës paraqet një detyrë të rëndësishme që synon të kuptojë sjelljen hidraulike dhe dinamikën geomorfologjike të këtij lumi. Lumi i Klinës, luan një rol kyç në ekosistemin rajonal dhe në mjetet e jetesës së komunitetit. Duke përdorur teknika të përparuara modelimi hidrologjik dhe hidraulik, ne kërkojmë të ndriçojmë ndërveprimin e komplikuar midis

rrjedhjes së ujit, transportit të sedimenteve dhe ndryshimeve geomorfologjike që formojnë rrjedhën e lumit.

Për të bërë modelimin hidraulik të lumit Klina, në qytet të Skënderajit, së pari kam bërë matjet gjeodezike të lumit dhe të sipërfaqes përreth në dy anët e lumit, në distancë deri në 1 km.

Pasi janë përfunduar matjet gjeodezike, matjet janë futur në softuerin inxhinierik Civil 3D, ku kam krijuar modelin digjital të terrenit (DTM) të pellgut të lumit dhe pastaj kam vizatuar aksin e lumit i cili korrespondon me gjendjen në terren.

Të dhënat e terrenit digjital, koordinatat e aksit, profilin gjatësor dhe profilet tërthore i kam eksportuar në HEC-RAS.

HEC-RAS na jep aftësinë për të simuluar profilet e sipërfaqes së ujit, vlerësuar zonat me rrezik për përmbytje dhe parashikuar ndikimet potenciale të ndryshimeve të rrjedhjes.

